

**Krizat financiare në Europën Juglindore.  
Shkaqet, tiparet dhe mësimet që duhen nxjerrë.**

**Marko Skreb**

**Evan Kraft**

**Kumtesë Përgatitur për Konferencën e Bankës së Shqipërisë**

**Dhjetor 2002**

**Tiranë**

## **PËRMBLEDHJE**

Ky studim analizon krizat sistematike financiare në tre vendet e Europës Juglindore: Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë dhe Kroaci (ABC). Kriza e Shqipërisë përfshiu sektorin informal financiar (skemat piramidale). Kriza e Bosnjës nuk pati ndonjë numër ngjarjesh përcaktuese, por në të ishte i pranishëm "stresi i përhershëm" dhe agjenda e përhershme e reformës së papërfunduar. Krizat e Kroacisë përfshinë një krizë të parë, që erdhi si rrjedhojë e tranzicionit dhe luftës, dhe një krizë më të vogël të dytë, që ishte rezultat i liberalizimit në mungesë të ndonjë kuadri të përshtatshëm institucional dhe ligjor.

Ne arsyetojmë se këto episode të ndryshme kanë pasur tipare të përbashkëta. Krizat kanë qenë shumë të kushtueshme, në secilin rast u përfshi politika, sistemi ligjor ka qenë pjesërisht i pamjaftuesëm dhe ka pasur mungesë bashkërendimi midis autoriteteve mbikqyrëse dhe institucioneve të tjera. Tipari i përbashkët pozitiv ishte se asnjëri nga vendet ABC nuk shkaktoi përhapjen e krizës jashtë vendit.

Ne arsyetojmë se mund të nxirren disa mësimë: konsensusi politik ka rëndësi thelbësore për marrjen e vendimeve në mënyrë të shpejtë, është me rëndësi vendimtare që të hartohet një plan i hershëm për zgjidhjen e krizës dhe administrimin e fuqishëm të krizës, për krizat nuk ka një politikë "të njëjtë për të gjithë" dhe pozicioni i fuqishëm fiskal është një plus. Më së fundi ne duhet të jemi të kënaqur që të kemi një krizë financiare, sepse vetëm pas krizës bëhen përpjekje të tjera për përmirësimin e stabilitetit të sistemit financiar.

## 1. HYRJE<sup>1</sup>

Qëllimi kryesor i këtij studimi është që të analizojë krizat sistematike financiare në tre vende të Europës Juglindore dhe të përpiqet të nxjerrë disa përfundime dhe mësimet të përgjithshme në bazë të atyre rasteve. Kumbësia shqyrton Shqipërinë, Bosnjë- Hercegovinën (BIH) dhe Kroacinë (ose "vendet ABC").

Përvoja e fundit me problemet financiare të këtyre tre vendeve nuk është studiuar gjerësisht. Përvojat janë krejt të ndryshme: Shqipëria ka kaluar një krizë financiare për shkak të krijimit dhe të rënies së skemave piramidale. Kjo krizë kishte pak të bënte me sistemin bankar, përveçse ndoshta që zhvillimi i sektorit informal financiar ishte rrjedhojë e mungesës së zhvillimit dhe elasticitetit të sektorit formal bankar. Përveç kësaj, parandalimi dhe zgjidhja e krizës nuk ishin kryesisht në duart e bankës qendrore, sepse ai institucion nuk kishte autoritet të qartë mbi sektorin informal financiar.

Bosnjë-Hercegovina kaloi vështirësi të zgjata të sistemit formal financiar pa ndonjë ngjarje të vetme ose seri ngjarjesh që mund të karakterizoheshin si krizë. Mbikëqyrja bankare funksionoi veçmas në secilin prej dy subjekteve të përcaktuara nga Marrëveshja e Dejtonit, duke krijuar ndryshime të ndjeshme në ritmin e ndryshimit dhe në shtrirjen e problemeve bankare. Megjithatë, problemet në të dyja subjektet dhe kuadri i përgjithshëm ligjor dhe makroekonomik ishin të ngjashme sa që e merituan termin "boshnjak".

Kroacia, dukshëm vendi më i zhvilluar ekonomikisht nga të tri vendet, kaloi dy kriza bankare. E para ishte rrjedhojë e kalimit nga komunizmi dhe kryesisht ishte rrjedhojë e rezervave të huave të këqija që ishin trashëguar nga sistemi i vjetër. Kriza e vjetër u zgjat dhe u zgjerua gjatë luftës së viteve 1991-1995. Menjëherë pas zgjidhjes së krizës së parë në vitin 1996, shpërtheu një krizë e re, kësaj here një krizë klasike e liberalizimit dhe rrezikimit të tepruar.

Megjithë këto histori disi të ndryshme, ne arsyetojmë se midis të tre rasteve ka ngjashmëri të rëndësishme, në mënyrë të veçantë vështirësitë e krijuara nga sistemet e dobëta ligjore, ndërhyrja politike në mbikëqyrjen e sektorit financiar dhe bashkërendimi i pamjaftueshëm midis institucioneve dhe qeverive.

Studimi përbëhet nga tre pjesë. Në vijim të kësaj hyrjeje në pjesën e parë kemi dhënë një analizë krahasuese të treguesve kryesorë ekonomikë, financiarë dhe

---

<sup>1</sup> Projekti fillestar i këtij studimi u paraqit në seminarin ndërkombëtar për "Përvojën krahasuese në ballafaqimin e problemeve të sektorit bankar në Europën Qendrore/Lindore dhe në Azinë Qendrore", 22-24 prill 2002, Varshavë, Poloni, organizuar nga Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Banka Kombëtare e Polonisë. Autorët do të dëshironin të falenderonin në mënyrë të veçantë Bankën Botërore dhe pjesëmarrësit për komentet e tyre të dobishme. Nuk është nevoja të thuhet se pikëpamjet e shprehura në kumbësë janë vetëm pikëpamje të autorëve dhe nuk duhet të lidhen me institucionet ku ata punojnë.

bankarë për vendet ABC. Në pjesën e dytë kemi analizuar veçmas problemet e sektorit bankar (sektorit financiar) në secilin prej tyre, duke bërë një vlerësim të administrimit të krizës në çdo vend. Në pjesën e fundit jemi përpjekur të nxjerrim disa përfundime dhe mësim nga këto përvoja.

## 2. TREGUESIT KRYESORË TË VENDEVE ABC

Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina dhe Kroacia nuk janë shumë të njohura. Këto dy të fundit dolën si shtete të pavarura para dhjetë vjetësh. Deri në fillim të tranzicionit Shqipëria ishte në mënyrë të diskutueshme midis vendeve më të mbyllura të botës. Pra, duket e dobishme që të jepet njëfarë informacioni përpara se të kalohet në problemet e tyre financiare.

Të tre vendet gjeografikisht janë të gjitha pjesë të Europës Juglindore. Siç mund të shihet nga tabela 2.1, të gjithë kanë një PBB për frymë relativisht të ulët. PBB-ja për frymë e Shqipërisë dhe e Bosnjë-Hercegovinës vlerësohet paksa më e lartë se 1.000 dollarë amerikanë (ose më pak se 3 dollarë amerikanë në ditë). Ajo e Kroacisë është dukshëm më e lartë. Duke vlerësuar PBB-në e përgjithshme, ekonomitë e tyre janë shumë të vogla. Por, të gjitha këto vende u zhvilluan relativisht shpejt në vitet nëntëdhjetë. Të gjitha treguan një shkallë shumë të lartë disipline monetare, siç u demonstrua nga inflacioni i ulët. Bosnjë-Hercegovina e arriti këtë me një politikë monetare "të mbështetur në rregulla", domethënë një këshill të monedhës (qysh nga viti 1997), ndërsa Shqipëria dhe Kroacia përdorën regjimet e administruara të kursit të lëkundshëm të këmbimit dhe politika monetare të pavarura.

**Tabelë 2.1: Treguesit ekonomikë për vitin 2001.**

	<b>PBB e përgjithshme në miliard usd</b>	<b>PBB/p.c. në usd</b>	<b>PBB/p.c. në PPP e në usd</b>	<b>Rritja e GDP-së</b>	<b>Inflacioni në % (eop)</b>
Shqipëria	4.1	1 108	3 488	6.5	3.5
Bosnjë-Hercegovina	4.6	1 068	s'ka	5.6	0.9*
Kroacia	20.3	4 625	7 892	4.1	2.8

Burimi: Artikulli IV i FMN-së i raporteve për Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën dhe Kroacinë ([www.imf.org](http://www.imf.org)) dhe Borish (2002).

Shënim: \* Vlerësimi (mesatarja e matur e të dyja subjekteve). Për inflacionin nën BIH nuk ka asnjë të dhënë.

Siç tregon tabela 2.2, deficitet e llogarive të tyre aktuale janë relativisht të larta (ai i Kroacisë në vitin 1997 ishte shifër me dy numra) dhe të gjitha kanë deficite fiskale. Deficiti i Shqipërisë është vërtet shumë i lartë (katër vjet më parë ishte në zonën e shifrës me dy numra). Asnjëri nuk ka asnjë treg financiar veçanërisht të thellë (siç matet nga pjesa e ofertave monetare në PBB), por të gjitha kanë

përjetuar ritme të larta të rritjes së parave.<sup>2</sup> Shqipëria dhe Bosnjë-Hercegovina kanë pjesë shumë të larta të monedhës në qarkullim në PBB. Nëse monedhës vendase, lehtësisht të matshme jashtë bankave, do t'i shtoheshin banknotat e monedhës së huaj (që qarkullojnë gjerësisht në të treja këto vende), ato mund të etikoheshin lehtë si "shoqëri të parave të thata".<sup>3</sup>

**Tabelë 2.2: Treguesit financiarë për vitin 2001.**

	<b>Llogaria e tanishme si % e PBB</b>	<b>Bilanci fiskal si % e PBB</b>	<b>Oferta monetare si % e PBB</b>	<b>Rritja e ofertës monetare në %</b>	<b>MJB** si % e PBB</b>
Shqipëria	-6.3	-8.5	66.7	19.9	20.2
Bosnjë-Hercegovina	-18.0	-0.9*	43.6	79	16.3
Kroacia	-3.1	-5.3	62.8	45.2	5.0

Burimi: Artikull IV i FMN-së i raporteve për Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën dhe Kroacinë ([www.imf.org](http://www.imf.org)).

Shënim:

\* Qeveria e konsoliduar qendrore në bazë të angazhimit.

\*\* Monedha jashtë bankave.

Me një fjalë, nëse në të ardhmen vazhdon rritja e shpejtë e PBB-së, ka hapësirë të bollshme për thellimin e mëtejshëm të tregjeve financiare. Njëkohësisht, thellimi financiar, nëse kombinohet me institucione të papërshtatshme financiare (kuadër i dobët rregullator dhe sidomos zbatim i dobët) dhe derregullim të shpejtë, mund të jetë recetë për problemet financiare në të ardhmen.<sup>4</sup>

Pasi i hodhëm një vështrim makroekonomik këtyre vendeve i kthehemi tani industrive të tyre bankare në veçanti.

**Tabelë 2.3: Treguesit bankarë për vitin 2000.**

	<b>Nr. i bankave</b>	<b>Të huaja</b>	<b>Banka për 100 000</b>	<b>Aktive/bank (mil usd)</b>	<b>Aktive/PBB</b>	<b>BERZH Treguesi*</b>
Shqipëria	13	12	0.38	155	52%	2+
Bosnjë-Herzegovinë	56	14	1.30	52	65%	2+
Kroacia	44	20	0.96	312	70%	3+

Burimi: Raporti i BERZH-it për tranzicionin (2002) dhe përlogaritjet e veta.

<sup>2</sup> Duhet shënuar se për shkak të kalimit nga marka gjermane në euro, fundi i vitit 2001 veçohet për vendet që kanë bërë zëvendësimin e monedhës së fortë dhe dollarizimin e lartë zyrtar dhe jozyrtar. Megjithatë, është karakteristike rritja e shpejtë e parave në përgjithësi.

<sup>3</sup> Për vlerësime të dollarizimit jozyrtar në Kroaci shih: *Feige et al* (2002) dhe CNB (2002a). Në Kroaci, në muajt e fundit të vitit 2001, u këmbyen para të huaja në një vlerë që kapte më shumë se 2.1 miliardë euro, duke treguar se monedha e huaj në qarkullim ishte gati dy herë më shumë se monedha vendase në qarkullim.

<sup>4</sup> Për shembull, Eichengreen dhe Arteta (2002) identifikojnë rritje të shpejtë të krediteve bankare të lidhura me liberalizimin financiar si shkaqe kryesore të krizave bankare në ekonomitë e tregut, që po krijoheshin. Shih gjithashtu Caprio dhe Klingebiel (1996) dhe Gavin dhe Hausmann (1996).

Shënim: \* Treguesi i BERZH-it për reformën bankare varion nga 1 deri në 4+ (kjo e fundit shënon pikën më të lartë). Dy pikë do të thotë se ka një liberalizim të ndjeshëm të shkallës së interesit dhe të shumës së caktuar për kredi. Tre pikë do të thotë se ka ecuri konkrete në krijimin e aftësisë paguese bankare dhe të një kuadri për mbikëqyrjen dhe për rregullimin e kujdesshëm. Për më shumë hollësi shih: *EBRD Transition Report (2001)*, f. 16.

Ia vlen të përmendet se si në BIH ashtu edhe në Kroaci numri i bankave është ulur ndjeshëm qysh nga viti 1997 (në Shqipëri aktualisht është rritur). Pritet që në të ardhmen konsolidimi të vazhdojë dhe sidomos që pjesa e tregut të bankave të huaja të vazhdojë të rritet me shpejtësi. Por, siç tregon tabela 2.3, përmasat mesatare të bankave në këto vende janë ende shumë të vogla. Ky është tipar tipik i një politike dhe licencimi relativisht të butë të hyrjes në fazat e hershme të tranzicionit. Përveç kësaj, ajo tregon që ato vende nuk janë imunizuar ndaj prirjeve të përgjithshme që prekin jo vetëm ekonomitë e zhvilluara, por edhe industrinë bankare të tregjeve të reja.<sup>5</sup>

Derregullimi, hapja ndaj konkurrencës së huaj dhe privatizimi do të vazhdojnë në të ardhmen meqenëse ato janë prirje botërore që ndikojnë në vendet ABC (shih Hawkings dhe Mihaljek, 2001). Me një fjalë, nuk ka dyshim se të gjitha vendet (duke përfshirë edhe ato ABC) janë të përfshira gjithnjë e më shumë në globalizim dhe do të këshilloheshin që t'i studjonin ato mirë dhe të përgatiteshin për to.

**Tabelë 2.4: Detyrimet ndërkombëtare (fondi i çerekut 1 të vitit 2002).**

	OBT	BE-MSA	FMN/BB/ BERZH	Grupim i mëvetshëm	Borxh i jashtëm
Shqipëria	po	jo	po	asnjë	jo plotësisht
Bosnjë-Hercegovina	jo*	jo	po	asnjë	jo plotësisht
Kroacia	po	po	po	BBB-	plotësisht

— Burimi: informacioni i vet.

Shënim:

OBT - Anëtarësia në Organizatën Botërore të Tregtisë.

BE-MSA - Marrëveshje e Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Europian të nënshkruara ose jo.

FMN/BB/BERZH - A (i) merr një vend (domethënë aktivet e veta, paratë e veta) nga institucione financiare shumëpalëshe. Si Shqipëria ashtu edhe Bosnjë-Hercegovina marrin në kushte koncesionale. Grupim i mëvetëshëm nga ndonjë agjenci kryesore (S & P, Moody's dhe Fitch IBCA).

Borxhi i jashtëm: Nëse borxhi i jashtëm është shlyer plotësisht apo jo.

\* BIH aktualisht është në bisedime për pranimin në OBT. Pritet që BIH të bëhet anëtare në vitin 2004.

Kroacia është vendi më i përparuar nga të tre vendet përse u përket detyrimeve ndërkombëtare. Meqenëse që të tre vendet janë pjesë e "periferisë" së tregut të stërmadh të BE-së (që do të bëhet edhe më e afërt kur të dhjetë vendet e reja kandidatë të bëhen anëtare me të drejta të plota, ndoshta pas dy vjetësh), nuk

<sup>5</sup> Për më shumë hollësi për prirjet në sistemin bankar të tregjeve të reja shih punën e shkëlqyer të Hawkings dhe Mihaljek (2001).

është çudi që BE-ja të jetë partneri i tyre kryesor tregtar. Kështu, marrëdhëniet institucionale me BE-në (aktualisht në formën e Marrëveshjeve të Stabilizim-Asociimit), si edhe zhvillimet tregtare janë çelësi për integrimin e tyre të mëtejshëm në tregun botëror.

Mund të arsyetohet se afërsia me BE-në përcakton (përgjithësisht) kuadrin ligjor për industrinë bankare. Të treja vendet tona përfshijnë banka të përgjithshme dhe kanë banka qendrore të pavarura me ligje moderne që sigurojnë pavarësinë (*de jure* nëse jo *de facto*). Ajo që nuk matet lehtë është çështja e zbatimit të ligjeve (sidomos në fushën bankare). Mund të argumentohet se vendet ABC nuk po i zbatojnë ashtu siç duhet ligjet e tyre. Në fakt, ky është vlerësimi i BERZH-it, siç e tregon tabela 2.5.

**Tabelë 2.5: Kuadri ligjor i operacioneve bankare.**

	L, Rr dhe M në bankën qendrore*	Ligji bankar	Mbyllja e bankave	Sigurimi i depozitave	Treguesi ** ligjor i BERZH-it
Shqipëria	po	korrik 1998 (i ndryshuar)	***	prill 2002	2-
Bosnja-Hercegovina	jo (dy subjekte)	tetor 1998	relativisht e lehtë	shkurt 2001 (vetëm FBIH)	1+
Kroacia	po	prill 1999 dhjetor 1998 (projekt i ri)	e lehtë	qershor 1997	3

Burimi: Raporti i BERZH-it për tranzicionin dhe vlerësimi i vet.

Shënim:

\* Licencimi, rregullimi dhe mbikëqyrja.

\*\* Treguesi i BERZH-it për tranzicionin ligjor është një sistem klasifikimi për rregullimin financiar. Shkalla më e lartë është 4+. Treguesi 1 tregon se rregullat ligjore në fushën bankare kanë fushë veprimi shumë të kufizuar, 2 nënkupton se ata janë të kufizuar dhe 3 nënkupton se ata janë të plotë, por përpunimi i mëtejshëm është i mundur. Për më shumë hollësi shih: *EBRD Transition Report (2001)*, f. 38-39.

\*\*\* Deri nga mesi i vitit 2002 asnjë nga bankat nuk është mbyllur, kështu që nuk është e mundur që të vlerësohet lehtësia e mbylljes së një banke.

Pas kësaj analize të shkurtër krahasuese do të shqyrtojmë më nga afër krizën sistematike financiare të çdo vendi.

### 3. KRIZAT FINANCIARE: VENDET ABC

#### 3.1. Shqipëria.

##### 3.1.1. Kuadri i krizës, kriza dhe administrimi i krizës.

Duhet të përmendet se deri tani Shqipëria nuk është ballafaquar me ndonjë krizë tipike bankare. Por, ajo ka pasur probleme shumë serioze që lidheshin me sektorin financiar. Problemet e saj financiare ishin më shumë të lidhura me zhvillimin dhe

me shembjen e bujshme të skemave piramidale dhe sidomos me rrjedhojat negative shoqërore dhe politike që solli kjo shembje për shoqërinë shqiptare në tërësi. Kështu, fakti që pjesa e parregulluar e sistemit financiar u zhvillua dhe solli një shkatërrim të tillë e bën rastin e Shqipërisë interesant.

Nuk ka dyshim se në fillim të tranzicionit Shqipëria u përball me kushtet më të këqija fillestare. Në fakt, kushtet fillestare të Shqipërisë jo vetëm që ishin më të këqijat nga ato të të tre vendeve që po krahasojmë, por më të këqijat nga ato të të gjitha vendeve europiane postsocialiste. Përpara vitit 1991 Shqipëria ishte vendi më pak i njohur dhe më i varfër në Europë.<sup>6</sup>

Në fillim të tranzicionit sistemi i saj financiar ishte i ngjashëm me atë të ish-vendeve të tjera socialiste. Sistemi i saj bankar përbëhej nga Banka Shtetërore e Shqipërisë (për të cilën ishte tipike që të kryente disa funksione qendrore bankare dhe bankare tregtare), Banka Shtetërore Bujqësore dhe Banka Tregtare Shqiptare. Funkzioni kryesor i Bankës Shtetërore Bujqësore ishte që t'u jepte hua kooperativave dhe fermave shtetërore. Banka Tregtare Shqiptare, që u krijua nga Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë i Bankës Shtetërore të Shqipërisë, merrej me rezervat e këmbimit të monedhës së huaj, me operacionet e këmbimit të monedhës së huaj etj.. Banka Shtetërore e Shqipërisë, gjithashtu, grumbullonte depozitat. Në të njëjtën, kohë rreth 40 mijë zyra vendore të Bankës Shtetërore gjendeshin të shpërndara në të gjithë vendin. Këta përfaqësues grumbullonin depozitat që ridepozitoheshin në Bankën Shtetërore të Shqipërisë.

Sistemi i pagesave ishte shumë rudimentar dhe punonte vetëm me para në dorë dhe me likuidimin e faturave bankare.

Por, reformat e rëndësishme në sistemin financiar filluan relativisht shpejt gjatë tranzicionit. Në prill 1992, banka e re qendrore dhe ligji bankar krijuan sistemin bankar të bankave dytësore. Banka Bujqësore më pas u mbyll duke lënë Bankën Kombëtare Tregtare (emri i ri i Bankës Tregtare Shqiptare) dhe Bankën e Kursimeve si bankat kryesore dytësore në Shqipëri. Banka qendrore u nda nga veprimtaritë bankare tregtare. Banka e parë e huaj filloi të funksionojë në Shqipëri në korrik të vitit 1993. Menjëherë filluan edhe disa banka të tjera private. Por, veprimtaria e të gjitha këtyre bankave u zvogëlua nga Banka Kombëtare Tregtare dhe sidomos nga Banka e Kursimeve, që kishin një pozicion mbizotërues në tregun e brendshëm.

Pavarësisht nga të gjitha ndryshimet institucionale dhe dalja e bankave të reja në atë periudhë, ndërmjetësimi financiar mbeti në gjendje shumë të dobët. Me fjalë të tjera, sektori financiar nuk e luajti rolin që mendohej të luante. Dhe kjo paaftësi e ndërmjetësimit formal, e kombinuar me mungesën e rregullimit të përshtatshëm

<sup>6</sup> Për të përfutur një pamje shumë të mirë të ekonomisë shqiptare përpara vitit 1992 shih Blejer e të tjerë (1992).



dhe me mungesën e njohurive për financat, ishin një terren pjellor për zhvillimin e skemave piramidale.<sup>7</sup>

Për shkak të mosbesimit të rrënjosur thellë tek institucionet financiare dhe të paaftësisë së sistemit të pagesave, privatët zinin një pjesë të madhe të aktivitetit të tyre financiar në para në dorë (shih grafikun 1). Me inflacionin që kishte arritur një shumë në dy shifra (30 % në vitin 1993 dhe 16 % në vitin 1994) kostoja e mundësisë së veprimit me para në dorë ishte e lartë.

Në të njëjtën kohë, tregu huadhënës ishte shumë i vogël dhe i pazhvilluar. Tre banka shtetërore dhe bankat e reja private që po krijoheshin nuk ishin të gatshme t'u jepnin hua privatëve dhe veprimtarive të vogla tregtare private. Kështu u krijua me shpejtësi një treg informal si për pranimin e depozitave ashtu edhe për dhënien e huave.

Në fillim të zhvillimit të tregut informal financiar, as rregullatorët as institucionet ndërkombëtare financiare nuk i shihnin këto veprimtari si të kundraligjshme. Përkundrazi, ato shiheshin si një plotësues i mirëpritur i ndërmjetësimit (të paefektshëm) zyrtar financiar. Pra, si tregjet huadhënëse ashtu edhe tregjet që pranonin depozita u zhvilluan nën hijen e ndërmjetësimit të paefektshëm formal financiar. Gjatë vitit 1995 shkalla e interesit të depozitave ishte 4-5 për qind në muaj.<sup>8</sup>

Meqenëse shoqëritë kërkonin të vepronin në bazë të Kodit Civil, rregullimi dhe kontrollimi i tyre ishte i vështirë. Por, sipas Jarvis (1999), "... problemi nuk ishte vetëm ligjor dhe (që) vetë anëtarët e qeverisë përfitonin dhe i mbështesnin shoqëritë e skemave piramidale" (f. 10). Ky është një element i rëndësishëm meqenëse kjo tërheqje e shtetit nga ana e palëve të interesuara kontribuoi për zhvillimin (dhe më vonë rënien) e skemave në Shqipëri.

Fatkeqësisht, banka qendrore nuk u përpoq që t'i mbyllte skemat piramidale në bazë të të drejtës së saj për të mbyllur bankat e palicencuara. Por, Prokurori i Përgjithshëm vendosi që skemat piramidale nuk përfshiheshin në ligjin bankar. Duke patur parasysh këtë dhe mospranimin nga ana e Ministrisë së Drejtësisë për t'u marrë me këtë çështje, duket se ka të ngjarë se banka qendrore nuk do të kishte pasur asnjë aleat nëse ajo do të kishte vepruar kundër skemave e vetme. Përveç kësaj, institucionet ndërkombëtare financiare, gjithashtu, i paralajmëruan autoritetet për skemat, por në një fazë relativisht të vonshme (kryesisht gjatë vitit 1996) dhe përsëri pa shumë efekt derisa hynë disi me vonesë në lojë.

<sup>7</sup> Përshkrimi ynë i ngritjes dhe i rënies së skemave piramidale në Shqipëri mbështetet tek Jarvis (1999) dhe Korovalis (1999).

<sup>8</sup> Një nivel mujor prej 4 për qind është afro 60 për qind në vit. Duke e krahasuar me shkallën e interesit vjetor prej 6-7 për qind të bankave, ndryshimi ishte shumë i madh.

Duhet përmendur, gjithashtu, se publiku nuk e kishte gjithmonë të lehtë të kuptonte që skemat piramidale nuk ishin sipërmarrje e ligjshme. Shumë investonin me bujë në aktive reale që ndoshta u sillnin ca fitime. Gjithashtu, disa pa dyshim "investonin" në veprimtari kriminale me përfitime të mëdha.

Në shembjen e skemave piramidale në fund të vitit 1996 dhe në fillim të vitit 1997 kontribuan dy ngjarje kryesore. E para ishte heqja e sanksioneve për Republikën Federale të Jugosllavisë në fund të vitit 1995. Kjo nënkuptonte se veprimtaritë fitimprurëse të kontrabandës, të financuara me paratë e skemave piramidale filluan të shterojnë. Së dyti, zgjedhjet e ardhshme parlamentare krijuan pasiguri nëse Partia Demokratike në pushtet (që i mbështeste aktivisht skemat) do të fitonte. Mbi të gjitha këto ishte edhe dinamika "normale" e skemave piramidale: herët a vonë ato gjithmonë shemben. Më tej akoma, rritja e konkurrencës (hyrjet e reja) çoi në rritjen e shkallës mujore të interesit në 6-10 për qind për gjysmën e parë të vitit 1996. Më së fundi, në nëntor të atij viti disa skema ofronin një interes mujor prej më shumë se 40 për qind në muaj. Në vjeshtën e vitit 1996 paralajmërimet ndërkombëtare (mbledhjet vjetore të FMN/BB në tetor) u bënë shumë më të forta dhe skemat piramidale filluan të bien brenda pak muajsh.

Në kohën e rënies skemat kishin mbi 2 milionë depozitues (nga një popullsi prej 3.5 milionë banorësh). Borxhet e fondeve të shtuara llogariteshin më shumë se 50 për qind e PBB-së. Pra, nuk ishte aspak çudi që trazirat civile nisën kur skemat filluan të mos i paguanin më depozituesit e tyre.

Ngadalë Shqipëria ra në anarki. Qeveria mori disa masa për të vlerësuar paratë që u kishin mbetur skemave, por ishte e qartë se ato ishin tepër të pakta dhe ky veprim ishte tepër i vonë. Në mars 1997 Shqipëria ishte në kaos. Policia dhe ushtria dezertuan, të huajt u larguan. Si rrjedhojë e përhapjes së trazirave u vranë rreth 2000 vetë dhe nga kazernat ushtarake e komisariatet e policisë u grabitën më shumë se një milion armë.

Nga mesi i vitit 1997 gjërat filluan të qetësohen. Me ndihmën e forcave ndërkombëtare, në korrik 1997, qeveria e përkohshme arriti të organizojë zgjedhje të reja dhe gradualisht vendit iu kthye qetësia.

Por, problemi i skemave piramidale ende nuk ishte zgjidhur. Nevojitej një ligj i ri për të siguruar bazën për vlerësimin dhe mbylljen e skemave piramidale. Çka i përkeqësoi gjërat ishte, se atëherë Presidenti Berisha nuk pranonte të nënshkruante dekretin për ligjin e skemave piramidale. Ligji i ri u nënshkrua vetëm në korrik 1997 pas zgjedhjes së presidentit të ri.

Ligji i ri sanksiononte se të gjitha skemat piramidale i nënshtroheshin kontrollit të administratorëve. Administratorëve iu dhanë fuqi të mëdha. Administratorët ishin të huajt dhe ata përballeshin me vështirësi të jashtëzakonshme (duke filluar nga

kërcënimet fizike deri tek sfidat ligjore). Pra, u deshën edhe disa muaj të tjerë, aftërsisht deri në mars të vitit 1998, që skemat të viheshin nën kontroll të plotë.

### 3.1.2. Administrimi i krizës: vlerësim.


Përvoja e skemave piramidale shqiptare nxjerr disa mësimë interesante:

- Problemet në sektorin financiar nuk është nevoja të lidhen me bankat apo me sistemin e rregulluar financiar. Tregjet informale financiare mund të dalin lehtë jashtë kontrollit. Shqipëria nuk është vendi i parë që përballët me skemat piramidale (MMM në Rusi, raste në Rumani, Kroaci etj.), por përmasat dhe sidomos rrjedhojat që patën skemat shqiptare i bëjnë ato që të jenë unike.
- Problemet e sektorit financiar mund të kenë rrjedhoja shkatërrimtare për shoqërinë civile dhe mund të shkakojnë trazira të mëdha shoqërore. Argjentina në vitin 2002 është një shembull tjetër që tregon se si problemet e mëdha në sektorin financiar (dhe humbjet e sektorit të pronave) mund të shndërrohen në një trazirë shoqërore dhe politike.<sup>9</sup>
- Reagimi me vonesë i autoriteteve u shkaktua jo vetëm nga kuadri i pamjaftueshëm ligjor por përgjithësisht ishte një problem qeverisjeje, domethënë i administrimit të krizës. Autoritetet reagues ngadalë dhe dobët. Lidhjet me nivelet më të larta të qeverisë dhe korrupsioni shtynë edhe për disa kohë reagimin e duhur. Kjo vonesë jo vetëm lejoi që skemat të zhvilloheshin, por gjithashtu vonoi shtënien në dorë të parave të mbetura, që lehtësoi zhvatjen e tyre.
- Është interesante të shënohet se, pavarësisht nga rrjedhojat shkatërrimtare politike dhe shoqërore, ndikimi ekonomik ishte relativisht modest. Sektori formal (domethënë bankat) nuk patën dëme. Duke i hedhur një sy të dhënave vjetore, mezi mund të shihet ndonjë ndikim mbi depozitat bankare, siç mund të shihet nga grafiku i mëposhtëm.

---

<sup>9</sup> Për të qenë krejtësisht të qartë, problemet në sektorin financiar nuk ishin shkak i problemeve makroekonomike të Argjentinës në fundin e vitit 2001. Përkundrazi, do të ishte më e drejtë të thuhet se bankat ranë viktimë të shembjes së ngrehinës monetare dhe të zemërimit popullor.

**Grafiku 3.1. Shuma e përgjithshme e depozitave dhe e monedhës jashtë bankave në Shqipëri.**



Burimi: Banka e Shqipërisë

\* të gjitha depozitat (depozitat me kërkesë dhe në kohë, lek dhe monedhë e huaj)

Në periudhën nga viti 1995 deri në fund të vitit 2001 oferta monetare (depozitat plus monedha) u rrit me një ritëm të vazhdueshëm, të shpejtë dhe pa ndërprerje madje edhe gjatë periudhës së krizës. Raporti i monedhës me depozitën u rrit nga 0.44 në fund të vitit 1996 në 0.58 në fund të vitit 1997, por menjëherë zbriti në 0.40 në fund të vitit 1998 dhe qëndroi në atë nivel deri në fund të vitit 2001.

Kjo nuk do të thotë se rënia e skemave nuk pati ndonjë rrjedhojë ekonomike. Inflacioni u rrit dhe rritja e PBB-së shënoi rënie nga 9.1 për qind në vitin 1996 në -7.0 për qind në vitin 1997 (ndonëse duhet vërejtur se të dhënat për PBB-në shqiptare ishin shumë të pasigurta). Por, duket se një pjesë e mirë e uljes së PBB-së duhet t'i atribuohet trazirave shoqërore, që bënë që për disa muaj jeta normale të ngecë në vend në një pjesë të mirë të vendit. Me një fjalë, rrjedhojat ekonomike të shembjes së skemave piramidale në vetvete ishin më të vogla nga ç'priteshin të ishin (siç shënon Jarvis, 1999).

Si rrjedhojë e shembjes së skemave piramidale, publiku mbeti tejet i ndjeshëm ndaj problemeve të sektorit financiar. Këtë e tregon qartë një episod, në mars të vitit 2002 me bankën më të madhe në Shqipëri. Banka kishte një bilanc të pastër. Të gjitha huatë e këqija ishin shlyer dhe banka ishte ristrukturuar me paratë e qeverisë. Banka e kishte të ndaluar të jepte hua, kështu që të gjitha aktivet e saj ishin ose në bono qeveritare, aktive të huaja ose kërkesa nga banka qendrore.

12

Banka priste të privatizohej (shpresohej që kjo të ndodhte relativisht shpejt). Pavarësisht nga bilanci i saj i pastër dhe cilësia e lartë e aktiveve, në mars të vitit 2002 filloi të thuhej se banka ishte e paaftë për të paguar dhe se njerëzit duhet të tërhiqnin depozitat e tyre, duke cituar rënien e skemave piramidale. Shkaku i këtyre thashethemeve nuk është i qartë, por për rrjedhojë brenda një muaji banka humbi 12 për qind të depozitave të saj. Pas kësaj gjendja u kthye në normalitet (tërheqjet pushuan), por depozitat nuk u kthyen në bankë. Në pikën kulmore daljet neto ishin 1 për qind e shumës së përgjithshme të depozitave në ditë. Ky është një rast akademik se si një vërshim në bankë mund të shkaktohet nga jo më shumë se sa thashethemet e mbështetura në një histori të vonshme të brengës financiare. Besimi humbet menjëherë, por është i vështirë për t'u rifituar.

Përfundimisht, ndërkohë sistemi shqiptar bankar ka vazhduar të zhvillohet në drejtimin e duhur. Aktualisht, ka 13 banka vetëm njëra nga të cilat është shtetërore (por ajo mbizotëron në afro 2/3 të tregut të depozitave). Aktualisht nuk ka asnjë rrezik të madh në sistem, por kujdesi është garanci për të ardhmen. Plus privatizimit të bankës më të madhe, nevojitet forcimi i mëtejshëm i mbikëqyrjes.<sup>10</sup>

### **3.2. Bosnjë-Hercegovina**

#### **3.2.1. Kuadri i zhvillimit bankar dhe kriza bankare<sup>11</sup>.**

Të përshkruash historinë e kuadrit bankar të BIH është njëloj si të përshkruash krizën/lëngimin e zgjatur të sistemit financiar. Nga fillimi i tranzicionit deri kohët e fundit sistemi ishte në një gjendje "stresi të përhershëm". Bosnjë-Hercegovina (BIH) nuk pati një krizë klasike bankare, por vështirësi serioze gjatë një dhjetëvjeçari (dhe ajo nuk është kapërcyer ende plotësisht). Kështu, BIH përfundimisht mund të klasifikohet në një grup vendesh me krizë sistematike financiare.

Bosnjë-Hercegovina u bë vend i pavarur në mars të vitit 1992, kur shpalli pavarësinë nga Republika Federale Socialiste e Jugosllavisë. Kjo u pasua nga një luftë e zgjatur që përfundoi vetëm në dhjetor 1995 me nënshkrimin e Marrëveshjes së Dejtonit për paqen.

Pra, gjatë katër viteve të gjatë, ndërsa disa ekonomi të tjera në tranzicion po reformonin në mënyrë të vrullshme sistemet e tyre financiare, populli i BIH bënte një luftë që përfundoi me më shumë se 250.000 fatkeqësi (ose afro 6 për qind të popullsisë së paraluftës). Nuk është nevoja të thuhet se konflikti çoi jo vetëm në

<sup>10</sup> Ne nuk do ta vazhdojmë më tej analizën e sistemit bankar shqiptar. Për më shumë hollësi shih: Siegelbaum e të tjerë, 2002, Cani e të tjerë (2000), Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes Bankare (2000) ose Muço e të tjerë (2001).

<sup>11</sup> Duhet shënuar se jo vetëm që për sistemin financiar të Bosnjë-Hercegovinës është shkruar shumë pak, por të dhënat statistikore ekzistuese janë cilësisht shumë të dobëta. Pa hyrë në hollësi për shkaqet e kësaj, lexuesit do t'i këshillohej që ta mbajë këtë parasysh.

humbje shumë të mëdha njerëzore, por edhe në shkatërrime fizike (strehimi, infrastruktura, faktorët) që vazhdojnë të pengojnë rimëkëmbjen e shpejtë.

Por, për në krye të herës duhet thënë se në kohën kur shpërtheu lufta sistemi financiar i Bosnjës ishte larg të qenurit i rregullt. Jo vetëm që ai vinte nga një sistem socialist (më liberal se shumica e ish vendeve socialiste, por sidoqoftë socialist<sup>12</sup>), por prishja e tregut të përbashkët jugosllav së bashku me një mori borxhesh të këqija e bënë shumë urgjente nevojën për një përshtatje serioze strukturore.

Shifrat në sistemin bankar të asaj kohe ishin të rralla. Por, sipas analizës së fundit të plotë të sektorit bankar, që ka bërë Coopers & Lybrand në vitin 1989, humbjet e mundshme të grumbulluara dhe të identifikuara në bankat e ish-Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë (RFSJ) shkonin deri në afro 10 miliardë dollarë amerikanë.<sup>13</sup> Nuk ekziston asnjë e dhënë vetëm për BIH, por mund të thuhet me siguri se, kur BIH u bë e pavarur, kapitali i sistemit bankar ishte thellësisht negativ.

Një element tjetër i rëndësishëm është se në prill të vitit 1991 të gjitha depozitat private në monedhë të huaj në bankat e BIH u ngrinë (ashtu si në të gjithë Republikën Federale Socialiste e Jugosllavisë). Problemi ishte shumë më i thellë se sa thjesht ngrirje depozitash, sepse Banka Kombëtare e Jugosllavisë kontrollonte aktivet e monedhës së huaj të vendit të mëparshëm. Bosnja, bashkë me Kroacinë, Slloveninë dhe Maqedoninë, kur u bënë të pavarura mbetën pa aktive homologe në depozita. Ky problem, në një kuptim, u krijua nga kërkesa në bazë të sistemit monetar të ish Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë që fitimet nga depozitat e valutës të dorëzoheshin në Bankën Kombëtare të Jugosllavisë.

Në atë kohë sasia e depozitave të ngrira për BIH vlerësohej të ishte 2.7 miliardë marka gjermane. Pa ndonjë interes të fituar, kjo është më shumë se 25 për qind e PBB-së së vlerësuar për BIH në vitin 2001. Ia vlen të vërehet se ky problem nuk është zgjidhur akoma në Bonjë-Hercegovinë (ndryshe, për shembull, nga Kroacia dhe Sllovenia). Pra, në bilancet e tyre bankat shtetërore ende kanë (pjesë të) këtij borxhi dhe privatët kanë ndaj bankave, kërkesa të cilat ato nuk mund t'i realizojnë.

Gjatë luftës sistemi bankar nuk funksionoi normalisht. Në BIH qarkullonin katër monedha: dinari boshnjak, dinari jugosllav, kuna kroate dhe marka gjermane. Bashkë me faktin se nuk kishte asnjë autoritet qeveritar që të mund të kontrollonte të gjithë territorin e BIH, është e kuptueshme që sistemi bankar nuk mund të ndërmjetësonte në mënyrë efektive për fondet në ekonomi.

Ndërkohë sektori real (dhe aftësia e tij shumë e kufizuar për të shlyer në rradhë të parë huatë) vetëm sa ishte përkeqësuar edhe më shumë. Bashkë me dëmet e

<sup>12</sup> Për më shumë hollësi për kuadrin bankar në socializëm shih *Croats and Skreb* (2002).

<sup>13</sup> Nga [www.nbj.yu](http://www.nbj.yu) <http://www.nbj.yu/english/banks/index.htm>

luftës (kontributet e donatorëve ndërkombëtarë për rindërtimin shkojnë në më shumë se 8 miliardë dollarë amerikanë sipas Tesche (2000)), është e qartë se i gjithë sistemi financiar në Bosnjë-Hercegovinë ishte në vështirësi serioze dhe kishte nevojë për një reformë të thellë.

Borxhi i jashtëm i parregulluar, që u shtojte të gjitha vështirësive në vend, ishte një pengesë për ndihmën ndërkombëtare. Kështu që, menjëherë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Dejtonit për paqen, BIH u bë anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar (20 dhjetor 1995).

Por vetëm në vitin 1998, pas krijimit të bankës qendrore, në të gjithë BIH u vendos një monedhë e vetme (marka e konvertueshme). Krijimi i një autoriteti të vetëm monetar për të gjithë vendin në tërësi (me ndihmën e madhe të institucioneve ndërkombëtare financiare - për më shumë hollësi shih Coats (1999)) dhe krijimi i dy agjencive të licencimit, të rregullimit dhe të mbikëqyrjes për të dyja subjektet bëri të mundur fillimin e ndërtimit dhe të ristrukturimit të sistemit financiar në Bosnjë. Në atë kohë BIH kishte banka shtetërore të vjetra, të mbytura në borxhe dhe të paristrukturuara, portofoli huadhënës i të cilave ishte thujtë krejtësisht jofunksionues dhe një grusht bankash të vogla private, që nuk luanin asnjë rol të rëndësishëm në ndërmjetësimin financiar.

Si rezultat i Dejtonit, BIH u bë një shtet i decentralizuar me dy subjekte, Federatën e Bosnjë-Hercegovinës (FBIH) dhe Republikën Serbe (RS). Duhet të përmendet menjëherë se reformat nuk ecën me të njëjtën shpejtësi në çdonjërin nga subjektet. Reformat në sektorin bankar ishin më të shpejta (ndonjëse jo shumë të shpejta) në FBIH sesa në RS.

Në të dyja subjektet reforma në industrinë bankare kishte dy drejtime. Së pari, vetë sistemi bankar duhet të ristrukturohej dhe, së dyti, sistemi i pagesave duhej të reformohej. Sistemi i pagesave ishte një problem i veçantë për shkak të mënyrës së tij të organizimit në ish-Jugosllavi. Përpara reformës kishte faktikisht tre zyra të pagesave (një në RS me lidhje të drejtpërdrejta me RF të Jugosllavisë dhe dy në FBIH). Problemi më i madh ishte pozita monopol e secilës prej tyre për të gjitha veprimet e pagesave në zonat e tyre gjeografike përkatëse. Përveç kësaj, zyrat e pagesave kryenin funksione të tjera të shumta (grumbullonin taksat, bënin revizionimin, luanin rolin e institucioneve të kleringut për bankat, bënin shpërndarjen e të ardhurave qeveritare dhe kryenin funksione statistikore).

Për të krijuar një infrastrukturë normale financiare të mbështetur në markën, duhej riformuar sistemi i pagesave. Për këtë reformë u vendos kuadri ligjor, u ngritën RTGS dhe institucionet e kleringut dhe më 5 janar 2001 sistemi i ri i pagesave filloi punën me sukses. Me këtë reformë bankat vunë nën kontroll pagesat. Tarifat për shërbimet e pagesave u ulën dhe tani ato formojnë një pjesë të të ardhurave bankare, në vend që t'i shkojnë agjencive shtetërore të pagesave.

Banka Qendrore e Bosnjë-Hercegovinës krijoi të gjitha parakushtet e nevojshme për funksionimin si duhet të sistemeve të RTGS dhe të shlyerjes së pagesave për operacione me rrezik mesatar. Ia vlen të shënohet se vetëm bankat, që kanë licenca të veçanta për të kryer shërbime të pagesave, mund ta përdorin sistemin e pagesave. Licenca e shërbimeve të pagesave jepet nga agjencitë bankare që ndodhen në çdo subjekt. Nga fundi i vitit 2001, 42 banka në BIH kishin licenca për të kryer veprime të sistemit të pagesave, 30 në FBIH dhe 12 në RS.<sup>14</sup>

Një tjetër problem i madh për bankat është borxhi i jashtëm i krijuar në ish-Jugosllavi. Shteti i BIH ka marrë vetëm borxhet e garantuara nga Federata Jugosllave ose nga ish-Banka Kombëtare e Jugosllavisë (duke përfshirë borxhet e klubeve të Londrës dhe të Parisit dhe të ashtuquajturat depozita private të ngrira në valutë).

Qysh nga Dejtoni është e pamundur që të flitet për një sistem të unifikuar financiar meqenëse çdo subjekt në BIH ka agjencinë e vet të mbikëqyrjes bankare. Për këtë arsye ne do ta trajtojmë secilën veçmas.

## **Federata e BIH**

Reformimi i vetë sektorit bankar u bë në tri mënyra. Së pari, duhet të eliminoheshin bankat e vjetra shtetërore. Së dyti, duhet të krijoheshin një kuadër i mjaftueshëm ligjor për sistemin bankar. Së treti, duhet të ngriheshin dhe të forcoheshin institucionet në mënyrë që të siguroheshin rregullimi dhe zbatimi i përshtatshëm i ligjeve dhe i rregullave.

Së pari, bankat e vjetra. Autoritetet u treguan të mençura që vendosën të mos përfshiheshin në ristrukturimin e bankave. Shteti nuk i ristrukturoi bankat me burime fiskale, as nuk i ndihmoi me dhënie borxhesh. Duhet kujtuar se sistemi i këshillit monetar në BIH nuk përmban dhënës të lehtësisë së mjetit të fundit po ashtu si edhe këshillat e tjerë monetarë në Europë, si në Bullgari dhe Estoni, që nuk kanë dhënës të lehtësisë së mjetit të fundit.

Qysh nga viti 1998 konsolidimi i sistemit bankar në FBIH ka ecur relativisht shpejt. Duhet vënë në dukje se kapitali negativ neto në fillim të reformës vlerësohej në 4.5 miliardë KM (*Banking Agency FBIH*, 2002, f. 6). Kjo mund të shihet nga tabela e mëposhtme:

---

<sup>14</sup> Për hollësi të tjera për sistemin e pagesave në BIH shihni [http:// platni.cbbh.ba/engl.htm](http://platni.cbbh.ba/engl.htm).



**Tabelë 3.2.1: Konsolidimi i sistemit bankar në FBIH.**

Data	Nr. i bankave (nga të cilat shtetërore)	Administrator i përkohshëm	Shlyerje	Falimentim
31 dhjetor 1998	55 (11)	-	-	-
31 dhjetor 1999	44 (10)	13	-	2
31 dhjetor 2000	38 (10)	2	4	4
31 dhjetor 2001	33 (6)	5	3	-
<b>Gjithsej</b>	<b>nuk ka</b>	<b>20</b>	<b>7</b>	<b>6</b>

Burimi: Agjencia Bankare e FBIH (2002).

Strategjia e reformës në sektorin bankar synonte që të lejonte zhvillimin e bankave të reja private dhe të lejonte që bankat e vjetra shtetërore, të mbytura në borxhe, ose të shkriheshin ose t'u shiteshin investitorëve strategjikë ose të eliminoheshin. Meqenëse këto banka ishin mbytur nga huatë e pariaftësueshme dhe kishin kushte shumë të dobta financiare kjo ishte një strategji e mençur.

Një shtyllë tjetër e reformës së sistemit bankar ishte miratimi i një kuadri të ri ligjor për bankat, sidomos për eliminimin e bankave të paafta për të paguar. Çka është më pak e lavdërueshme është se afati për mbylljen e bankave shtetërore, që nuk janë privatizuar ose që nuk janë shkrirë, është shtyrë tashmë disa herë. Kjo nuk krijon stimuj të mirë për sjellje të disiplinuar, meqenëse aktualisht bankat shtetërore që kanë mbetur nuk i plotësojnë plotësisht kërkesat ligjore për kapital.

Shtylla e fundit ishte ndërtimi dhe forcimi i institucioneve. Kjo përfshinte zbatimin e mbikëqyrjes bankare dhe krijimin e një sistemi të sigurimit të depozitave. Agjencia bankare e FBIH është krijuar nga fundi i vitit 1996 dhe qysh atëherë është zhvilluar në një institucion të pavarur të respektuar në FBIH.<sup>15</sup> Kohët e fundit ka filluar nga puna edhe agjencia e sigurimit të depozitave. Në FBIH sigurimi i depozitave është i përshtatshëm dhe, në fillim të vitit 2002, 8 banka kishin licenca për të siguruar depozitat (sigurohet deri në 5000 KM për depozitë). Në pjesën e dytë të vitit 2002 u krijua agjencia e sigurimit të depozitave në nivel të Bosnjë-Hercegovinës.

Me një fjalë, reforma bankare nuk pati ecuri të madhe, por ka qenë më e ngadaltë se sa ç'pritej (sidomos marrja e vendimit për bankat shtetërore nëpërmjet shkrirjes ose eliminimit) dhe shënonte një ndikim të fuqishëm politik në proces. Fakti më i dobishëm është se bankat e huaja private kanë pasur ecuri të ndjeshme në këto dy vitet e fundit, duke fituar pjesë të tregut dhe duke e pozicionuar veten e tyre për konkurrencë serioze në të ardhmen.

<sup>15</sup> Nga *Banking Agency FBIH* (2002).

## Republika e Serbisë<sup>16</sup>

Në RS në mesin e vitit 1998 u krijua një agjenci bankare, ndërsa në sistemin bankar ende mbizotërojnë bankat shtetërore. Hapësira ekonomike e RS është shumë e vogël (në vitin 2000 PBB e përgjithshme vlerësohej të ishte 1.2 miliardë dollarë amerikanë), kështu që një numër i përgjithshëm prej 18 bankash duket si një numër relativisht i madh (me aktive mesatare për bankë që vlerësohen vetëm 60 milionë KM në fund të vitit 2001). Një problem tjetër është se 10 nga 18 bankat ishin kryesisht shtetërore<sup>17</sup> deri në mesin e vitit 2001 dhe ato përfaqësonin më shumë se 80 për qind të aktiveve të përgjithshme.

Por, tipari kryesor është se bankat nuk janë ndërmjetës të rëndësishëm financiarë. Pjesa e aktiveve të përgjithshme bankare në PBB ishte 43 për qind në fund të vitit 2000. Por kursimet e përgjithshme private (të rejtat duke përjashtuar llogaritë e ngrira në vitin 1991) shkonin në jo më shumë se 50 milionë KM ose më pak se 2 për qind të PBB-së të vlerësuar për RS. Ky është një tregues shumë i qartë i besimit tejet të ulët në sistemin bankar.

Disa tipare të bankave në RS mund të shihen nga tabela e mëposhtme.

**Tabelë 3.2.2: Bilanci i bankave në RS që kanë para të depozituara.**  
- në milionë KM -

	Dhjetor 1997	Nëntor 2001
Aktive gjithsej	748	1 106
- o/w aktive të huaja	63	101
- o/w kërkesa për sektorin privat	683	946
Borxhe të huaja	532	526

Burimi: *Bosnia and Herzegovina, Statistical Appendix (2002)*, f. 17.

Është e qartë se një pjesë e madhe e kërkesave për sektorin privat janë huatë e vjetra jofunksionale dhe të pariaftësueshme. Për të njëjtën arsye, elementi më i rëndësishëm në borxhet bankare janë borxhet e huaja që në një masë të madhe nuk mund të shlyhen (depozita të ngrira valutore).

Industria bankare në RS është shumë e paefektshme. Problemi kryesor me bankat shtetërore (dhe me sistemin bankar në tërësi) në RS është punësimi i tepërt. Deri në mesin e vitit 2001, aktivet mesatare për punonjës shkonin vetëm në 234 mijë KM (ose më pak se 100.000 dollarë amerikanë për punonjës). Kjo krahasohet në

<sup>16</sup> Të dhënat për Republikën e Serbisë, nëse nuk janë deklaruar ndryshe, janë marrë nga *Banking Agency RS*, 2001.

<sup>17</sup> Në fund të prillit 2002 njëra prej tyre, Kristal Banka, Banja Luka iu shit bankës austriake Hypo-Alpe Adria Bank.

mënyrë të pafavorshme me mesataren e bankave kroate prej 1.100.000 dollarësh amerikanë për të njëjtën periudhë (Banka Kombëtare Kroate 2002b). Në regjistrat e tyre, bankat shtetërore ende kanë borxhe të këqija dhe depozita të ngrira në valutë dhe nuk kanë zgjidhje për këto probleme, bilanci i bankave nuk pasqyron shkallën e vërtetë të ndërmjetësimit financiar.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2002, tek autoritetet është ushtruar presion i fuqishëm ndërkombëtar që ose të mbyllnin ose të privatizonin tri bankat kryesore shtetërore.

### **3.2.2. Problemi bankar dhe administrimi i krizës në BIH: vlerësim.**

- Sistemi bankar në BIH është përballur me një trashëgimi të vështirë socialiste, shumë të ngjashme me Kroacinë. Kapitali fillestar negativ i sistemit bankar dhe fakti që bankat patën luajtur funksione të papajtueshme me ekonominë e tregut nënkuptonin se ristrukturimi do të ishte një detyrë tepër e madhe. Plus kësaj, lufta dhe përçarjet politike të një vendi tejet të decentralizuar kanë ngadalësuar reformat dhe kanë shkatërruar sektorin real të ekonomisë (burimet njerëzore, infrastrukturën, aftësinë prodhuese etj.). *De facto* reforma në sektorin financiar filloi vetëm para pesë vjetësh (1997).
- Strategjia e sektorit bankar kishte dy shtylla kryesore: reformën e sektorit bankar (që përfshin reformën e bankave shtetërore, krijimin e një kuadri të ri ligjor dhe krijimin dhe forcimin e institucioneve) dhe reformën e sistemit të pagesave.
- Sot kuadri ligjor për sistemin bankar është (pak a shumë) i përshtatshëm. Kështu janë edhe institucionet (një bankë qendrore, agjenci bankare në të dyja subjektet). Duhet të vërehet se sigurimi i depozitave është i pranishëm në FBIH, por jo në RS. Sot problem nuk janë aq shumë ligjet bankare por zbatimi i tyre për të gjitha institucionet që pranojnë depozita. Reforma e bankave shtetërore po vazhdon me një ritëm më të ngadaltë se ç'pritej, kështu që për të gjitha bankat nuk zbatohen të njëjtat kriteret e mjaftueshmërisë së kapitalit.
- Një mësim i rëndësishëm që duhet nxjerrë është nevoja për një qëndrim të plotë ndaj ristrukturimit të sistemit financiar. Është vështirë ta reformosh sistemin bankar pa reformën e mjaftueshme të pjesëve të tjera të sistemit, sidomos të infrastrukturës financiare. Kështu që një element shumë pozitiv është ndryshimi në sistemin e pagesave në BIH.<sup>18</sup>
- Megjithatë, problemet në sektorin financiar qëndrojnë. Së pari, hapësira e vogël ekonomike është e ndarë në njësi edhe më të vogla. Do të ishte e dobishme që të rritej bashkërendimi, sidomos për mbikëqyrjen e bankave dhe për harmonizimin e rregullimit. Nisma që mbikëqyrja duhet të jetë nën

<sup>18</sup> Politika e një qëndrimi të dyfishtë për transformimin e bankave dhe të sistemit të pagesave në vendet, që kanë kaluar një konflikt, nga ana e FMN-së është një politikë shumë pozitive. Shih Lonnberg (2002).

"ombrellën" e bankës qendrore duket si një nismë pozitive. Por, pengesa të fuqishme politike janë ende të pranishme dhe çdo nismë që "zvogëlon" pushtetet e subjekteve kundërshtohet me forcë.

- Depërtimi i bankave të huaja është shumë më i rëndësishëm në FBIH sesa në RS. Bankat e huaja po hyjnë në BIH pavarësisht nga rreziku i vendit relativisht i lartë (BIH nuk ka klasifikim formal, por në bazë të të gjitha standardeve rreziku i vendit është i lartë).
- Në të dyja subjektet duket se problemi kryesor janë procedurat e papërshtatshme dhe shumë të ngadalta gjyqësore. Kreditorët nuk mbrohen sa duhet, siç ndodhte në socializëm.<sup>19</sup> Ky është një shembull i mirë që tregon se nuk mjafton reforma vetëm në sektorin financiar pa reforma të përshtatshme ligjore në fusha të tjera dhe një kuadër ligjor të përgjithshëm financiar që të jetë i qenësishëm dhe të zbatohet më së miri. Kuadri i përshtatshëm ligjor është një koncept i plotë në financë. Nuk arrihet shumë duke trajtuar vetëm çështjen e ligjit bankar nëse të drejtat e pronësisë nuk janë të përcaktuara qartë dhe nuk janë të mbrojtura mirë.
- Administrimi i krizës bankare nga autoritetet mund të etiketohet si i pamjaftueshëm, në mënyrë të veçantë në fazat e hershme. Problemi më i madh ka qenë politika. Politikanët kanë ngurruar që të ndërmarrin lëvizjet e guximshme të nevojshme për transformimin e sistemit të vjetër bankar, sidomos për të kufizuar të drejtat vendore. Me presionin e fuqishëm të komunitetit ndërkombëtar, reforma po ecën, por siç u përmend më ngadalë nga ç'pritej.
- Më së fundi, njerëzit e humbën besimin tek bankat për shkak të ngrirjes së depozitave dhe të kohës së lufës. Por, ky besim po rikthehet. Përveç stabilitetit të siguruar nga këshilli monetar, procesin e kanë ndihmuar edhe disa goditje të jashtme pozitive. Me fillimin e procesit të "shndërrimit në euro" në banka vijnë më shumë para nga ç'pritej. Kjo është dëshmi e qartë e zëvendësimit të valutës së fuqishme, edhe në kushtet e një këshilli monetar dhe të një besimi të pakët në sistemin bankar vendas. Por, problemet qëndrojnë.

### **3.3. Kroacia**

#### **3.3.1. Kuadri i krizës**

##### *Liberalizimi dhe rregullimi*

Tregu bankar kroat u liberalizua shumë në fillim të viteve nëntëdhjetë. Edhe përpara shpërbërjes, në vitin 1989 Jugosllavia socialiste zbatonte një ligj bankar relativisht liberal. E rëndësishme është se u vendos mbikëqyrja bankare dhe u zbatuan standardet e kapitalit Basle.

---

<sup>19</sup> Ky problem është i gjithëpranuar si një nga problemet kryesore për zhvillimin më të shpejtë të sistemit bankar. Shih, për shembull, fjalimin e Guvernatorit Nicholl për reformën në sistemin bankar (Nicholl, 2001). 20

Pasi Kroacia fitoi pavarësinë, në vitin 1993, parlamenti i saj bëri ligjin e vet për bankat dhe për bankat e kursimeve. Ky ligj vazhdoi procesin e liberalizimit. Kapitali minimal që kërkohej për bankat u vendos në monedhën vendase, që ishte i barasvlefshëm me 5 milionë dem, ndërsa kapitali minimal që kërkohej për bankat e kursimeve ishte vetëm 1 milion dem.<sup>20</sup>


Për fat të keq, ligji i linte pak dorë të lirë bankës qendrore për dhënien e licencave. Formulimi i ligjit e bënte të vështirë të mohohej dhënia e licencës në raste të parëndësishme, ku kishte thjesht një përshtypje të fortë se kandidati nuk ishte i përshtatshëm dhe nuk ishte ndonjë "pushkë që nxirrte tym" e që mund të mbahej në gjyq. Arsyeja themelore e një ligji të tillë liberal, si në shumë vende të tjera në tranzicion, ishte dëshira për të rritur konkurrencën, si edhe dëshira për t'u dhënë sipërmarrësve vendorë mundësinë që të hynin në veprimtarinë tregtare bankare.

Në bazë të këtyre ligjeve relativisht liberale dhe të praktikave më pak të rrepta të licencimit, numri i bankave u rrit me shpejtësi nga 22, që ishte fillimisht në vitin 1990, deri në afro 91 në vitin 1997. Jo të gjithë kandidatët e rinj ishin privatë: edhe disa subjekte qeveritare ngritën banka. Në fund të viteve nëntëdhjetë një numër i madh i këtyre bankave - si private ashtu edhe shtetërore - do të hasnin probleme. Analiza e efektshmërisë faktikisht sugjeron se bankat e reja shpeshherë ishin *më pak* të leverdishme sesa bankat e vjetra (Kraft dhe Tirtiroglu, 1998). Duke hedhur vështrimin prapa duket se përfitimet e hyrjeve të krijuara duke rritur konkurrencën dhe duke mësuar, më shumë ishin balancuar nga kostoja që kërkonte përballimi i dështimit të gjithë këtyre institucioneve, apo madje kjo kosto i kishte kaluar ato. Kjo do të thotë se rregullat e hyrjes thjesht ishin tepër liberale.

---

<sup>20</sup> Bankat e kursimeve fillimisht nuk kishin të drejtë të bënin veprime në valutë. Ato as nuk mund të jepnin hua tregtare. Atyre iu njoh e drejta për të pranuar depozita në valutë dhe të drejta të kufizuara për të bërë veprime në valutë më pas dhe u eliminuan si kategori e ndarë nga bankat, në bazë të ligjit të bankar të miratuar në fund të vitit 1998.

**Figura 3.3.1: Numri i bankave në Kroaci.**



Burimi: Banka Kombëtare Kroate.

*Kriza fillestare dhe përpjekjet për zgjidhjen e saj.*

Kriza fillestare e sistemit bankar të Kroacisë ndahej në dy faza. Së pari, në vitin 1991 autoritetet kuptuan se shumtë e parave të bankave për shumë ndërmarrje të drejtuara nga shoqëri nuk mund të mblihdeshin dhe për t'i mbuluar këto shuma parash nxorrën obligacionet (të quajtura "Obligacionet e Mëdha"). Obligacionet kapnin shumën prej 1 miliard dollarësh amerikanë ose përbënin afërsisht 5 për qind të PBB-së. Por, fatkeqësisht nuk ishte zgjedhur çasti i duhur, sepse kjo ndodhi pikërisht përpara fillimit të luftimeve në verën e vitit 1991. Përveç kësaj, skema e "Obligacioneve të Mëdha" nuk përfshinte dispozita të përshtatshme që i detyronin bankat ose ndërmarrjet të ndryshonin qëndrimin e tyre.

Sistemi bankar pësoi edhe një goditje tjetër në vitin 1991 kur Banka Kombëtare e Jugosllavisë ngriu depozitat private në valutë (shih diskutimin më sipër për Bosnjën). Kur në verën e vitit 1991, Kroacia u përjashtua nga sistemi monetar jugosllav, sistemi bankar kroat mbeti pothuajse pa asnjë rezervë valutore.

Ndonëse qeveria i garatoi menjëherë depozitat e ngrira, ajo nuk e filloi zhbllokimin e tyre deri në vitin 1995. Është shumë e rëndësishme që të vërehet se kjo ngjarje pati efekte të fuqishme tek besimi i depozituesve, që do të ndihej gjatë gjithë dhjetëvjeçarit.

Faza e dytë e krizës erdhi pas programit të suksesshëm të stabilizimit makroekonomik të tetorit të vitit 1993, që arriti ta ulë inflacionin mujor nga mbi 35 për qind në muaj, në zero ose në muajt pasardhës arriti të shënojë madje nivele

negative.<sup>21</sup> Me uljen e inflacionit llogaritë e bankave u bënë më transparente. U bë e qartë se banka më e madhe e vendit dhe tri banka të mëdha rajonale (të renditura përkatësisht e treta, e katërta dhe e pesta për nga aktivet e përgjithshme) kishin dështuar. Shkaqet e këtyre vështirësive ishin një përzierje e problemeve që lidheshin me luftën, me përgjegjësitë e trashëguara nga sistemi i vjetër dhe me problemet e reja.

Kriza bankare e viteve 1994-1996 u shpreh në mënyrë më të dukshme në veprimin e shkallëve të interesit ndërbankar. Tri nga bankat e dështuara nuk dispononin para dhe merrnin shuma të mëdha nga tregjet ndërbankare. Bankat arritën të merrnin hua meqenëse pjesëmarrësit në tregje prisnin që këto banka faktikisht do të shpëtoheshin. Por, ankthi i madh i këtyre bankave që nuk dispononin para dhe që merrnin hua e çoi interesin deri në 30 për qind. Përveç kësaj, në vitin 1994 sistemi bankar në tërësi regjistroi humbje neto.

Ndaj rehabilitimit të këtyre bankave pati rezistencë të madhe politike. Drejtuesit në detyrë arsyetonin mundimshëm se fajin nuk e kishin ata. Ata mbështeteshin nga mbrojtësit e politikave të buta të huadhënies dhe nga fakti që kreditin e drejtonte qeveria. Në një rast, drejtuesit në detyrë arritën t'i mbanin postet e tyre dhe të fitonin një dorëzani. Por në tre të tjerat, faktikisht drejtuesit e vjetër u hoqën, aktivet e këqija (jo të gjitha, por shumica) u shlyen, u futën para dhe Agjencia për Rehabilitim e Bankave u bë pronarja e bankave.<sup>22</sup> Në periudhën e mëvonshme puna e bankave u përmirësua në mënyrë të ndjeshme. Më së fundi, gjatë vitit 1999 dhe në fillim të vitit 2000, qeveria ishte në gjendje t'ua shiste shumicën e aksioneve të të katër bankave partnerëve të huaj.

Këto masa zgjidhën në mënyrë të efektshme atë çka Kawalec (2002) e quan problem të rezervave: ekzistencën e një rezerve të madhe borxhesh të këqija në regjistrat e bankave. Rehabilitimi, gjithashtu, zgjidhi problemin e hyrjeve në këto banka të caktuara, meqenëse ato nuk merrnin më sasira të mëdha borxhesh të reja të këqija. Por, siç do ta shohim më poshtë, diku tjetër në sistemin bankar kishte probleme të mëdha të hyrjeve.

#### *Kuadri makroekonomik.*

Në shumë kuptime kuadri makroekonomik i Kroacisë gjatë gjysmës së dytë të viteve nëntëdhjetë duhet të ketë qenë i favorshëm për zhvillimin e sistemit bankar. Inflacioni ishte i ulët. Në vitin 1998 ai arriti nivelin maksimal prej 5.3 për qind falë efekteve të veçanta të futjes së taksës së vlerës së shtuar. Rritja e PBB-së ishte e shpejtë për shkak të rikonstruksionit të kohës së luftës dhe të rimëkëmbjes së kërkesës dhe kreditit.

<sup>21</sup> Për më shumë hollësi për stabilizimin shih Anušić e të tjerë (1995).

<sup>22</sup> Për më shumë hollësi për procesin e rehabilitimit shih Lovegrove (1998).

**Tabelë 3.3.1: Inflacioni dhe rritja e PBB-së në Kroaci, 1994-2001.**

	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001
PBB*	5.9	6.8	6	6.5	2.5	-0.3	3.7	4.1
RPI**	-3	3.8	3.4	3.8	5.4	4.4	7.4	2.6

\* ritmi real i rritjes së PBB-së.

\*\* inflacioni i çmimeve të shitjes me pakicë, eop.

Por, po krijohet një zbalancim i madh i jashtëm. Rritja e shpejtë e konsumit ndihmoi në shtimin e deficitit të llogarisë aktuale nga 5.8 për qind të PBB-së në vitin 1996 në 11.6 për qind të PBB-së në vitin 1997. Lulëzimi i konsumit u shkaktua nga rritja e shpejtë e kreditit për konsumatorin, i cili arriti në jo më pak se 93 për qind në vitin 1997. Në të njëjtën kohë, filloi hyrja e fuqishme e kapitaleve, duke ndihmuar kështu në forcimin e stabilitetit nominal të kursit kryesor të këmbimit midis kunës dhe markës gjermane. Hyrjet e kapitalit kishin katër përbërës: rikthimin e depozitave që kishin qytetarët kroatë jashtë shtetit; marrjen e huave në valutë nga qeveria në formën e obligacioneve; ndihmat humanitare dhe ndihmën tjetër të huaj; dhe duke filluar nga fillimi i vitit 1997, kur për herë të parë Kroacia mori një klasifikim të shkallës së kreditit për investimet, pati rrjedhje të kapitalit privat, kryesisht të huave bankare.

Në mesin e vitit 1997 politika monetare u shtrëngua dhe Banka Kombëtare i pakësoi blerjet e saj të valutës (kanali kryesor për krijimin e parave). Fatkeqësisht, politika fiskale nuk u shtrëngua përkatësisht dhe deficitit i llogarisë aktuale arriti në përmasa kërcënuese.

Duke parë se shtrëngimi i monedhës konvencionale nuk po ngadalësonte lulëzimin e kreditit, në prill 1998 Banka Kombëtare reagoi duke vënë kontrolle të tipit kilian mbi kapitalin (Šonje 1998). Këto kontrolle rritën koston e marrjes së huave nga të huajt dhe ndihmuan në ngadalësimin e shtrirjes së kreditit. Duket qartë se këto masa çuan në probleme financimi për disa banka agresive, të cilat qenë mbështetur në marrjen e huave nga jashtë për shtrirjen e tyre.

Ndikimi i kontrolleve të kapitalit u forcua nga zhvillimet e pafavorshme në mjedisin ndërkombëtar. Bankat kroate vazhduan të merrnin hua pavarësisht nga kriza aziatike, por e ndienin se kriza ruse ishte shumë më e madhe. Për më tepër, në vjeshtën e vitit 1998 disa banka të mëdha gjermane filluan bojkotimin e Kroacisë në shenjë proteste kundër refuzimit të bankës qendrore për të rehabilituar *Glumina Banka*, një bankë private e dështuar, tek e cila ata kishin mungesë të madhe mbrojtjeje. Këto elemente të aspektit të subvencioneve të huamarrjes ndërkombëtare ishin, gjithashtu, të rëndësishme për ngadalësimin e hyrjeve të kapitalit.



Ngadalësimi i hyrjeve të kapitalit dhe të kreditit sigurisht luajti rol në fillimin e rënies në tremujorin e katërt të vitit 1998. Shumë firma të mëdha, veçanërisht ato që ishin të lidhura me të ashtuquajturit "industrialistë" të cilët kishin ngritur grupe të mëdha korporatash, patën vështirësi të ndjeshme. Recesioni do të vazhdonte gjatë gjithë tremujorit të tretë të vitit 1999.

### *Probleme politike të ekonomisë.*

Siç kanë vënë në dukje Caprio dhe Klingebiel (1996), Gavin dhe Hausman (1996) dhe Eichengreen dhe Artesta (2002) lulëzimet e kreditit zakonisht çojnë në kriza bankare. Gjatë vitit 1997 për drejtuesit e bankës qendrore ishte e qartë se mund të pritej që disa banka të kishin probleme. Sidoqoftë, disa probleme politike të ekonomisë i kishin zënë rrugën përpjekjes së vrullshme për t'i zgjidhur këto probleme në mënyrë proaktive.

Së pari, një kapital shumë i madh politik ishte shpenzuar për të bindur qeverinë që të trajtonte problemet e rezervave. Rehabilitimi i katër bankave pati qenë tepër i kushtueshëm (afërsisht 4 për qind e PBB-së), ndonëse është e vërtetë se shumë prej këtyre shpenzimeve ishin në formën e obligacioneve dhe jo në para. Nuk ishte e lehtë në atë kohë që t'u drejtoheshe përsëri politikanëve.

Së dyti, në sipërfaqe çdo gjë dukej se shkonte mirë. Fitimet e bankave ishin të larta, gjendja e kreditit po përmirësohej, konsumatorët më së fundi arritën të kishin në dorë mallrat që ata nuk patën qenë në gjendje t'i blinin gjatë periudhës së luftës dhe depresionit të tranzicionit. Kjo nuk krijoi një kuadër të mirë për paralajmërimet për probleme të menjëhershme bankare.

Së treti, vetë lobi bankar që bërë shumë i fuqishëm dhe kishte vendosur lidhje të mira. Besohej gjerësisht se ndikimi politik mbi huadhënien e bankave ishte i madh dhe kjo u siguronte bankierëve mbulesë politike. Ata sigurisht ishin të përgatitur për t'iu kundërvënë përpjekjeve për forcimin e mbikëqyrjes bankare.

Këto probleme politike të ekonomisë ishin veçanërisht të rëndësishme sepse ishte bërë e qartë se kuadri ligjor ishte i pamjaftueshëm. Ligji i vitit 1993 për bankat dhe për bankat e kursimeve, thjesht nuk siguronte masat e menjëhershme të mjaftueshme për veprim korigjues. Ai as nuk siguronte një mekanizëm real për falimentimin bankar. Në praktikë i vetmi mekanizëm daljeje ishte rehabilitimi, sigurisht jo i përshtatshëm për trajtimin e problemeve në numrin edhe më të madh të bankave të vogla dhe të mesme.


Për të gjitha këto arsye, kur bankat filluan të dështojnë, banka qendrore ishte tejet e kufizuar në aftësinë e saj për të reaguuar. Ndoshta, duke pasur parasysh vonesat në trajtimin e problemeve të rezervave dhe pengesat e tjera politike të ekonomisë, kjo ishte e pashmangshme.

### 3.3.2. Kriza

"Kriza e Dytë Bankare" e Kroacisë (Kraft 1999) mund të datohet qysh nga marsi i vitit 1998, kur në *Dubrovačka Banka*, asokohe banka e pestë më e madhe në vend për nga aktivet e përgjithshme, pati një kërkesë të beftë. Shpejt u bë e qartë se banka ishte thellësisht e paaftë për të paguar para dhe kishte dëshmi të fuqishme të veprimtarisë kriminale. Banka ishte rehabilituar nga qeveria për shkak të pozicionit të saj mbizotërues në rajonet e Dubrovnikut.

Kriza vazhdoi me një seri të ngadalë dështimesh gjatë gjithë vitit 1998. Punët u acaruan në fillim të vitit 1999 kur dështimet filluan të bëhen më të shpeshta dhe besimi i përgjithshëm i depozituesve ishte tronditur. Periudha shkurt-maj 1999 shënoi rënie të numrit të përgjithshëm të depozitave, siç mund të shihet nga figura më poshtë.

**Figurë 3.3.2.1: Numri i përgjithshëm i depozitave në bankat kroate, 1997-1999.**



Burimi: Banka Kombëtare Kroate.

Në përgjithësi, afro 14 banka pësuan dështime menjëherë në vitet 1998 dhe 1999 dhe nja 6 të tjera morën huanë e mbështetjes së mjetit të fundit. Vlerësohej se bankat e dështuara përbënin 17.3 për qind të numrit të përgjithshëm të aktiveve të sistemit bankar në fund të vitit 1997. Kostot e rregullimit, duke përfshirë rehabilitimin e dy bankave dhe pagesat për sigurimin e depozitave për 12 të tjera, arrinin 4.8 për qind të PBB-së.

Bankat e dështuara ishin të gjitha private. Disa ishin banka të reja të krijuara qysh nga viti 1990, ndërsa të tjerat ishin banka më të vjetra të krijuara si banka rajonale gjatë periudhës komuniste. Por edhe në rastin e këtyre bankave të fundit nuk dukej se shkak kryesor i dështimit ishte rezerva e huave të këqija, që ishte trashëguar nga kohët e mëparshme, por në fakt huadhënia e pamatur gjatë

periudhës pas luftës. Huadhënia e lidhur ishte një pjesë shumë e rëndësishme e problemit në shumë banka.

### 3.3.3. Administrimi i krizës

Dështimi i *Dubrovacka Banka* në fillim të krizës ishte një moment i rëndësishëm. Prova të forta gabimesh iu atribuan pronarëve dhe drejtuesve të bankës, të cilët ishin në pozita mbrojtjeje dhe forcuan dorën e bankës qendrore. Vendimi për të mos dhënë dorëzani për bankën dhe për të shpërndarë këshillin drejtues dhe këshillin mbikëqyrës ishte një kundërshtim i rëndësishëm ndaj atyre, të cilët këmbëngulnin se banka që drejtuar mirë dhe ishte thjesht një viktimë pasive e makinacioneve politike.

Sidoqoftë, kur banka qendrore u përpoq në maj që të fillonte procedurat e falimentimit për një bankë tjetër në vështirësi, dolën në pah dobësitë e sistemit ligjor. Gjykatat nuk pranorin ta hapnin çështjen, duke e kthyer atë mbrapsht tek banka qendrore që të merrte në shqyrtim rehabilitimin. Do të kalonin afërsisht gjashtë muaj midis arkivimit të parë për falimentim dhe refuzimit të Bankës Kombëtare Kroate për të rehabilituar bankën, që ia ktheu çështjen gjykatave.

Përveç kësaj, kur nga fundi i qershorit dështoi edhe një bankë tjetër private, dolën në dritë probleme të tjera. Drejtuesit vazhduan të qëndrojnë në bankën e dështuar duke u marrë me zhatjen e parave, duke ndihmuar individë të ndryshëm që t'i ndanin depozitat, që e kapërcenin kufirin e sigurimit të depozitave, në depozita më të vogla plotësisht të siguruara në emër të miqve apo të familjes dhe duke bombarduar median me histori se si investitorët e huaj do ta shpëtonin së shpejti bankën. Edhe pse në vjeshtë banka qendrore e hodhi poshtë rehabilitimin e bankës si ekonomikisht të pajustificueshme, asnjë zgjidhje nuk u gjend.

Në fund të dhjetorit, ligji i ri bankar u kalua më së fundi dhe hyri në fuqi në 1 janar. Menjëherë banka kombëtare dërgoi në bankat e dështuara administratorë të përkohshëm. Administratorët arritën ta pengonin zhatjen e parave dhe ndarjen e depozitave. Të gjitha raportet e tyre rekomandonin qartë falimentimin. Pasi Këshilli i Bankës Kombëtare Kroate i la në fuqi këto rekomandime, Banka Kombëtare Kroate kërkoi, që në fund të marsit të vitit 1999, të fillonin procedurat e falimentimit për katër banka. Kësaj here gjykatat i pranuan kërkesat dhe procedurat e falimentimit u hapën.

Përveç përdorimit të mekanizmit të përkohshëm të administratorit, në janar të vitit 1999, Banka Kombëtare përdori gjithashtu të drejtat e saj që ia jepte ligji i ri bankar për t'u siguruar bankave të afta për të paguar, por që nuk dispononin para, të ashtuquajturat "hua me aftësi paguese". Qëllimi ishte që këto hua të ishin të fshehta, por u zbuluan shpejt nga shtypi. Huatë u dhanë me kushte të rënda siç ishin kufijtë për përmasat e huadhënies, pushimi i pagesave të dividendëve,

përmirësimet e administrimit të rreziqeve dhe struktura organizative për kufizimin e rrezikut moral.

Sidoqoftë, nga pikëpamja e administrimit të krizës, çka është e rëndësishme është se këto hua stabilizuan gjendjen në gjashtë bankat marrëse, duke parandaluar një krizë edhe më të gjerë. Për të pasur një ide të efekteve të mundshme, vëreni se 6 banka përbënin 5.8 për qind të sistemit bankar dhe të gjitha kishin pozicione të fuqishme ose mbizotëruese në disa tregje vendore.

Hapi tjetër i rëndësishëm, që u ndërмор gjatë krizës bankare, ishte vendimi për rehabilitimin e *Croatia Banka*. Në pranverën e vitit 1998 kontrollorët e jashtëm gjykuan se banka kishte qenë e aftë për të paguar, por kishte hasur në probleme të borxheve, në shkurt të vitit 1999. U dha një hua me aftësi pagueuse, por ekipi mbikëqyrës i Bankës Kombëtare Kroate shpejt zbuloi se banka ishte thellësisht e paaftë për të paguar para. Atëherë çështja u shtrua nëse duhej mbyllur kjo bankë, që kishte një rrjet shumë të gjerë kombëtar të shitjeve me pakicë. U vendos se efektet mbi besimin e depozituesve do të ishin tepër të mëdha dhe banka u rehabilitua. Rihapja e saj për punë në mars të vitit 1999 ishte një shtysë e rëndësishme psikologjike.

Pas hapjes së procedurave të falimentimit në fund të marsit, gjendja mbeti e nderë. Numri i përgjithshëm i depozitave vazhdonte të binte. Lufta në Kosovë krijoi fantazmën e një krize më të gjatë ekonomike. Sidoqoftë, në prill dhe në maj nuk pati më dështime bankare dhe fillimi i qershorit solli fundin e luftës në Kosovë. Depozitat filluan të rriten përsëri në qershor me rimëkëmbjen e turizmit dhe me fashitjen e krizës.

### **3.3.4. Vlerësim i administrimit të krizës**

#### *Pafundësia e reagimit.*

Një nga problemet kyçe të krizës kroate ishte paaftësia e bankës qendrore për të reaguar ndaj problemeve bankare në kohë. Për shkak të dobësive të ligjit të vjetër bankar, banka qendrore arriti të ndalonte veprimtaritë e bankës vetëm kur ajo u bë krejtësisht e paaftë për të paguar para dhe iu drejtua bankës qendrore për ndihmë. Bankës do t'i jepej lehtësia e "huasë së ndërmjetme", që u jepej bankave në mënyrë që të ishin në gjendje të përmbushnin angazhimet e tyre ndërbankare. Kjo lehtësi kërkonte që banka të paraqiste një plan për rivendosjen e aftësisë pagueuse dhe, gjithashtu, çoi në bllokimin e llogarive të bankës. Me shumë të drejtë bankierët e perceptuan huanë e ndërmjetme si dënim me vdekje.

Përvoja tregon se për njëfarë kohe mund të ndodhë që bankat mund të kenë aftësi pagueuse por të mos jenë të afta për të paguar para. Për shkak të kësaj, banka qendrore zakonisht ishte në gjendje vetëm të bllokonte llogaritë e bankës

kur ajo bëhej thëllësisht e paaftë për të paguar para. Për më tepër, meqenëse sipas ligjit të vjetër ajo nuk kishte fuqinë t'i hiqte drejtuesit në detyrë, banka qendrore nuk ishte në gjendje të parandalonte zhvatjen e parave dhe ndarjen e depozitave në bankat e dështuara.

Ligji i ri i trajtonte këto probleme në mënyrë konkrete. Administratori i përkohshëm e kishte të drejtën t'i përzinte drejtuesit dhe të ndalonte veprimtarinë e papranueshme. Sidoqoftë, mekanizmi i administratorit të përkohshëm mund të aktivizohej vetëm pas konstatimit të mbikëqyrjes se banka nuk ishte e aftë të paguante para. Kjo, gjithashtu, nuk i përmbush plotësisht kërkesat për një veprim të menjëhershëm korigjues.<sup>23</sup>

Depozituesit e perceptuan ardhjen e administratorit të përkohshëm si një shenjë se banka do të shkonte drejt falimentimit. Sidoqoftë, kjo ishte një profeci vetëkënaqjeje, meqenëse kërkesat e befta të depozituesve në disa raste e shtynë bankën deri në buzë të humnerës. Kjo nënvizon rëndësinë e ndërhyrjes më të hershme dhe të vendimit të shpejtë për të lejuar mbylljen shpejt të bankës dhe rihapjen e saj vetëm pasi të jenë gjetur pronarët praktikë.

#### *Mekanizmi i daljes.*

Siç e përmendëm më lart, 14 nga 16 bankat që dështuan në vitet 1998 dhe 1999 shkuan drejt falimentimit dhe vetëm 2 u rehabilituan. Autoritetet kroate nuk përdorën shkrirjet e detyruara. Ata, gjithashtu, nuk qenë në gjendje të përdornin masat e orientimit ndaj tregut siç është blerja dhe marrja përsipër, ndihma për realizimin e shkrirjeve etj..

Duke pasur parasysh se kriza ishte kryesisht një rrezikim i tepruar dhe jo rrjedhojë e forcave madhore (për shembull, e luftës dhe e trashëgimisë së komunizmit), prirja drejt falimentimit ishte e justifikuar. Bankat e dështuara përgjithësisht ishin thëllësisht të paafta për të paguar para, kishin drejtues të dobët dhe shpeshherë nuk kishin arritur të vepronin në përputhje me rregullat. Thjesht nuk kishte asnjë bazë që nga shumica e këtyre bankave të dështuara të krijoheshin institucione të shëndosha bankare. Pra, falimentimi, ndonëse shumë i dhimbshëm, ishte ndoshta zgjidhja e drejtë.

Është gjithashtu e rëndësishme që të theksohet se dy bankat e rehabilituara gjatë krizës kaluan një periudhë kohe shumë më të vështirë për t'u rimëkëmbur sesa bankat që u rehabilituan në vitet 1995-96. Këto të fundit faktikisht qenë viktimat të forcave madhore në njëfarë mase. Përveç kësaj, autoritetet ishin shumë më në

<sup>23</sup> Sipas ligjit bankar që po shqyrtohej aktualisht në Parlamentin Kroat në mes të vitit 2002, bankës qendrore i jepet e drejta për të hequr drejtuesit edhe në bankat e afta për të paguar, nëse kapitali është dëmtuar dhe banka nuk ka mundur të paraqesë një plan ristrukturimi. Përveç kësaj, sipas ligjit të propozuar, banka qendrore do të ishte në gjendje t'i hiqte drejtuesit nëse mjaftueshmëria e kapitalit do të binte nën 2.5 për qind.

gjendje, që në mes të krizës së përgjithshme, t'i përqendronin burimet në katër bankat e mëdha se ç'ishin në gjendje të vepronin me dy bankat e rehabilituara.

Ndërsa do të dëshironim të ishim të kujdesshëm në lidhje me nxjerrjen e përfundimeve të përgjithshme, do të sugjeronim se prirja drejt falimentimit në një krizë të rrezikimit të tepruar ishte e përshtatshme. Mund të diskutohet nëse një institucion i caktuar duhet shpëtuar në kulmin e panikut, siç u bë me *Croatia Banka*, por përfundimi i përgjithshëm duket se është se: kur mekanizmat e orientuar drejt tregut dështojnë, është më mirë që të falimentohet një bankë që e do rrezikun sesa të bëhen përpjekje për ta rregulluar atë.

#### *Bashkërendimi i politikës.*

Përveç dobësive të ligjeve bankare, vështirësitë në bashkërendimin e politikës ishin një shkak kryesor i reagimit të ngadaltë ndaj problemeve bankare në Kroaci. Siç vërejnë Šreb dhe Šonje (2001), nuk kishte asnjë plan të logjikshëm për të cilin të ishte rënë dakort që të përdorej për të shpëtuar sistemin bankar. Për rehabilitimin bankar kishte një mekanizëm të qartë, meqenëse zyrtarë të lartë të qeverisë dhe të bankës qendrore bënë pjesë në Këshillin e Agjencisë për Rehabilitimin e Bankës, por nuk kishte asnjë mekanizëm të qartë për dhënien e fondeve për shkrirjet për të cilat jepej ndihmë, për blerjen dhe marrjen përsipër apo për veprime të tjera më të orientuara drejt tregut. Kjo mungesë mbështetjeje ishte sigurisht një arsye pse në Kroaci nuk u zbatuan zgjidhje të tilla.

Më përgjithësisht, mungesa e bashkërendimit çoi në vonesa të mëdha të politikës dhe në pasiguri të madhe në lidhje me drejtimin e zgjidhjes së krizës. Šreb dhe Šonje (2001) i ndanë vonesat në pesë etapa: në etapën e perceptimit, në etapën 1 të veprimit, në etapën e bindjes, në etapën 2 të veprimit dhe në etapën ligjore. Pa dashur ta ritregojmë të gjithë historinë këtu, ne thjesht mund të përmendim pikën kryesore: fragmentizimi i përgjegjësisë acaroi vonesat dhe e bën zgjidhjen e krizës më të vështirë dhe më të kushtueshme.

#### *Sigurimi i depozitave.*

Sigurimi i depozitave filloi në korrik të vitit 1997. Fillimisht u siguruan depozitat e privatëve deri në 30.000 kuna kroate për person për bankë, ku u siguruan 75 për qind e depozitave nga 30.000 deri në 50.000 kuna kroate. Faulend (2001) vlerëson se ky nivel mbulonte 80 për qind të depozituesve, që duket se është një shifër e mjaftueshme.

Sidoqoftë, në verën e vitit 1998, Ministri i Financave e ngriti nivelin e sigurimit në 100.000 kuna kroate. Ishte e qartë se ky vendim u mor nën presionin e një numri të madh personash që kishin depozituar në disa nga bankat e dështuara. Ky nivel e vendos maksimumin e mbulimit të Kroacisë/PBB për frymë në shifrat 3.3, që

është më i lartë se në të gjitha vendet e Europës përveç Norvegjisë dhe Italisë, dhe madje më i lartë se në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Garcia 1999). Në bazë të rënieve në mbarë vendin, Faulend vlerëson se niveli i mbulimit ishte 92 për qind mbi vlerën e parashikuar duke pasur parasysh karakteristikat e vendit (Faulend 2001).

Është diskutuar shumë për dobishmërinë e një garancie-mbulesë për depozitat gjatë një krize bankare. Sidoqoftë, në Kroaci ka pak të dhëna se garancia e sigurimit të depozitave ndikoi në qëndrimin e depozituesve të vegjël. Përkundrazi, në shumë raste kërkesat e befta erdhën në bazë të thashethemeve, edhe pse shumica e atyre kërkesave të befta ishin të siguruara.

Për më tepër, autoritetet u treguan jashtëzakonisht të ngadalta në shlyerjen e sigurimit të depozitave. Në rastin e *Glumina Banka*, banka më e madhe që shkoi drejt falimentimit, depozitat ishin të ngrira deri nga fundi i qershorit 1998, procedurat e falimentimit u hapën nga fundi i marsit 1999 dhe shumica e depozitorëve u shlyen vetëm në dhjetor 2000. Pra, është e lehtë të kuptohet pse sigurimi i depozitave nuk u konsiderua i besueshëm.

Pikëpamja jonë është se garancia-mbulesë vetëm do ta kishte rritur koston e zgjidhjes së krizës. Ajo do të kishte shërbyer si dorëzani për depozitorët, të cilët në përgjithësi duhet ta kishin ditur më mirë sesa t'i vinin paratë e tyre në banka që ofronin interesa të lartë të dyshimtë. Efekti i përgjithshëm mbi besimin e publikut ndoshta do të kishte qenë minimal dhe kostot të mëdha.

#### *Dhënës i mjetit të fundit.*

Në rastin kroat dhënësi i lehtësisë së mjetit të fundit eci mirë. U shmang përqendrimi i dështimeve gjatë një periudhe të shkurtër, duke ruajtur besimin dhe duke fituar kohë për një zgjidhje përfundimtare. Nga të gjashtë bankat të cilave iu dha ndihmë, dy janë marrë tashmë nga investitorë të huaj. Në fund të vitit 1999 njëra prej tyre doli se ishte e paaftë për të paguar, por u shpëtua nga rivlerësimi i obligacioneve të mëdha në pranverën e vitit 2000.

Kishte dy çelësa për suksesin e dhënësit të lehtësisë së mjetit të fundit. I pari ishte kushtëzimi i fuqishëm i huave. Kjo siguroi se bankat do të bënin përpjekje të plota për të bërë përmirësime, duke ulur sa më shumë rrezikun e ndonjë dështimi përfundimtar. I dyti ishte gjendja relativisht e fuqishme makroekonomike, duke përfshirë sidomos inflacionin e ulët. Krijimi i parave të bankës qendrore me anë të dhënësit të mjetit të fundit nuk pati një ndikim të ndjeshëm inflacionist në sajë të nivelit të përgjithshëm të ulët të inflacionit (dhe nivelit të ulët të veprimtarisë ekonomike në vitin 1999). Ky është një përfitim i rëndësishëm i politikave të shëndosha makroekonomike.

Është interesante të ballafaqohet rasti i Kroacisë me atë të Bullgarisë në këtë drejtim. Kur filloi kriza bankare bullgare në fund të vitit 1995, gjendja fiskale ishte e tillë që nuk mund të ofrohej asnjë fond publik. Përveç kësaj, mekanizmi i daljes nuk funksiononte, kështu që e vetmja mundësi ishte ndihma nga Banka Kombëtare Bullgare. Por kjo e çoi vendin në hiperinflacion (Balyozov 1999, Enoch, Gulde dhe Hardy 2002). Kroacisë iu kursye ky fat nga politikat më të mira makro dhe nga ekzistenca e mekanizmit të daljes që, ndonëse tejet i ngadaltë dhe i kushtueshëm, nuk lejoi që problemet e rezervave të zgjidheshin përpara krijimit të një krize makro.

#### **4. TIPARE TË PËRBASHKËTA TË KRIZAVE SISTEMATIKE DHE MËSIMET E NXJERRA**

##### **4.1. Tipare të përbashkëta të krizave financiare**

1. Krizat financiare janë shumë të kushtueshme, pavarësisht nga shkaqet e tyre të ndryshme. Në Shqipëri kriza u shkaktua nga lindja e institucioneve financiare informale të parregulluara. Në Bosnjë-Hercegovinë problemet lidheshin kryesisht me trashëgiminë e sistemit financiar socialist dhe me rrjedhojat shkatërrimtare të luftës. Në Kroaci kriza e parë bankare ishte rezultat i tranzicionit dhe luftës dhe e dyta ndodhi kryesisht për shkak të politikave të buta të kombinuara me një kuadër të dobët ligjor dhe mbikëqyrje me të meta. Por, në të treja rastet kostot ekonomike të krizës së sektorit financiar janë shumë të mëdha dhe ndoshta më të larta se një e treta e PBB-së vjetore. Është shumë e vështirë të vlerësohen shifrat e sakta. Në Kroaci u vlerësua se të dyja krizat së bashku kishin një kosto fiskale që ishte sa një e treta e PBB-së (Šreb dhe Šonje 2001). Në Shqipëri detyrimet e përgjithshme të skemave piramidale, që u shembën, ishin më shumë se gjysma e PBB-së. Jo të gjitha këto ishin kosto fiskale, por një vlerësim shumë i përafërt i kostove si një e treta e PBB-së nuk duket i tepruar. Për Bosnjë-Hercegovinën metodologjia e llogaritjes së kostove ishte edhe më e vështirë, por depozitat e ngrira në valutë (dhe ende të pazgjidhura) vetvetiu llogariten në më shumë se një e katërta e PBB-së për vitin 2000 (pa interesin e fituar). Pra, kostot e përgjithshme të këtyre krizave financiare mund të përlllogariten afërsisht sa një e treta e PBB-së.
2. Krizat sistematike financiare që analizuam kishin "një përbërës politik" të fuqishëm. Nuk mund të themi se vetë krizat u shkaktuan nga politika, por në Kroaci<sup>24</sup> reagimi politik ndaj krizës ishte i ngadaltë dhe ngurroi "të përfshihej" ose qëllimisht u përpoq ta shtynte zgjidhjen (në Shqipëri gjatë periudhës së skemave piramidale dhe në BIH sot e kësaj dite).
3. Problemet ligjore në parandalimin dhe zgjidhjen e krizës ishin të pranishme në të gjitha vendet. Mungesa e një kuadri të përshtatshëm ligjor ka vonuar

<sup>24</sup> Në Kroaci mençuria konvencionale ishte se, meqenëse kriza "shkattohet" nga banka qendrore, vetëm banka qendrore duhet të fajësohet për të dhe rrjedhimisht, vetëm ajo duhet ta zgjidhë krizën. Për më shumë hollësi për kundërshtimin politik ndaj zgjidhjes së krizës në Kroaci shih Šreb dhe Šonje (2001).



veprimin në rastet e Shqipërisë dhe të Kroacisë. Në BIH asnjë veprim nuk është marrë për të zgjidhur problemin pa presionin e fuqishëm të komunitetit ndërkombëtar. Kuadri ekzistues ligjor, menjëherë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Dejtonit për paqen, ishte i pamjaftueshëm për të trajtuar problemet financiare. Në të tre vendet vetë kriza detyroi miratimin e legjislacionit të ri dhe rregullimin e sistemit financiar, që është një tipar pozitiv.

4. Bashkërendimi i politikës në administrimin dhe zgjidhjen e krizës midis autoriteteve mbikëqyrëse<sup>25</sup> dhe institucioneve të tjera ishte relativisht i dobët në të gjitha vendet ABC. Në Kroaci, Ministria e Financave ishte shumë ngurruese që madje të diskutonte zgjidhjen e problemeve bankare (shih Šreb dhe Šonje, 2001). Në Shqipëri gjatë ngritjes së skemave piramidale askush nuk donte të merrej me to. Për shumë kohë ato ishin "problemi i askujt". Në Bosnjë-Hercegovinë për shkak të kufizimeve institucionale as qeveria (qeveritë) as banka qendrore nuk mund të përfshiheshin drejtpërsëdrejti, por zgjidhja më e shpejtë e problemeve ekzistuese (depozitat e ngrira në valutë) do të rriste besueshmërinë e sistemit financiar dhe do të intensifikonte tregjet financiare.
5. Një tipar pozitiv i përbashkët i krizave është se asnjë nga vendet ABC nuk u përpoq që ta përhapte atë përtej problemeve të veta (shih tabelën 2.1.). Në BIH asnjë fond qeveritar nuk është përdorur posaçërisht deri tani për të zgjidhur problemet bankare. Në Shqipëri qeveria vendosi të mos i garantojë depozitat e skemave piramidale, që për atë kohë ishte një vendim shumë i guximshëm. Në Kroaci qeveria rehabilitoi disa banka me fonde fiskale (rritja e borxhit publik) dhe shleu depozitat e siguruar në bankat e dështuara. (Në fakt, nuk ishte e mjaftueshme të paguhej më shumë se një pjesë e vogël e depozituesve.) Por, në asnjë nga këto zgjidhje nuk u përdorën paratë e bankës qendrore (ndryshe nga Republika Çeke, për shembull, ku subvencioni i zotëruar tërësisht nga banka qendrore *Ceska finacni* futi kapital në banka gjatë Programit të Stabilizimit të viteve 1996-1997<sup>26</sup>).

#### 4.2. Mësimet e nxjerra

1. Është shumë e rëndësishme që të ekzistojë konsensusi politik që zgjidhja e krizës të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur. Humbjet vijnë menjëherë pas shpërthimit të krizave. Me kalimin e kohës ato veçse zgjerohen, kështu që "loja" kryesore është si të rishpërndahen. Nëse nuk zgjidhen menjëherë përpjekjet për të pasur sa më pak humbje që të jetë e mundur, zgjidhja e

<sup>25</sup> Në Shqipëri për shumë kohë nuk ishte e qartë cili duhej të merrej me skemat piramidale. Në Bosnjë qysh nga viti 1997 agjencitë bankare të subjekteve kanë qenë përgjegjëse për çështjet bankare dhe në Kroaci këtë përgjegjësi e ka Banka Qendrore. Shih tabelën 2.5.

<sup>26</sup> Shih Banka Kombëtare Çeke (1999).

krizës mund të vonojë ndjeshëm dhe kostot të rriten shumë.<sup>27</sup> Dhe kjo loja e rishpërndarjes nuk do të zgjidhet pa konsensus politik. Sa më shpejt të kuptohet se humbjet nuk do të largohen vetvetiu, por se dikujt do t'i duhet t'i përballojë ato, aq më mirë është. Të gjitha vendeve do t'u këshillohej që të mos jenë mohuese në lidhje me natyrën e krizës financiare dhe të kostove të saj.

2. Është e nevojshme të ekzistojë një plan për zgjidhjen e krizës ose një kuadër për zgjidhjen e saj. Asnjëri nga vendet ABC nuk kishte një plan paraprak për trajtimin e problemeve financiare. Në mesin e krizës, kur vendimet duhen marrë në një situatë të mungesës së plotë të informacionit, është shumë më e vështirë që të shmangen gabimet e mëdha. Përveç të pasurit të këtij plani, administrimi i krizës (ose mirëqeverisja siç quhet nganjëherë) është shumë i rëndësishëm. Këtu ne pajtohemi me Fischer (2001) se drejtimi i efektshëm i një krize është "i vetmi faktor më i rëndësishëm për administrimin e krizave financiare" (f. 6). Shqipëria tregon qartë se si mungesa e drejtimit në fazat e hershme mund ta ndërlikojë problemin fillestar.
3. Sipas mendimit tonë nuk ekziston një politikë më e mirë për zgjidhjen e krizave financiare. Nisur nga vendet ABC është e vështirë të dalësh me një listë të "praktikave më të mira" për raste të tilla. Ne kemi mendimin se zgjidhja e krizave është më shumë një art sesa një shkencë. Zgjidhja e krizave (sidomos e krizave sistematike) kërkon që autoritetet të marrin parasysh jo vetëm kushtet ekonomike, por edhe mjedisin politik dhe shoqëror. Zgjidhja nuk duhet të mbështetet në dogma ideologjike të çfarëdo lloji,<sup>28</sup> por duhet të mbështetet në *realpolitik*. Kështu, për të përsëritur mësimin e mëparshëm, vendeve duhet t'u këshillohej që të mendonin për zgjidhjet e mundshme (brenda një kuadri të gjerë) shumë më përpara.
4. Vendet duhet "në kohë të mira" të lënë mënjanë fonde për raste të paparashikuara në vitet e krizave.<sup>29</sup> Të paktën gjatë fazave të ciklimit të biznesit ato duhet të vënë rregull në llogaritë e tyre fiskale. Një pozitë e fortë financiare e fillimit dhe inflacioni i ulët (kontrolli i fuqishëm monetar) përfundimisht janë elemente pozitive për zgjidhjen e krizës. Në aspektin pozitiv, mjedisi i Kroacisë me inflacion të ulët lejoi që banka qendrore të ndërmerre veprimet e dhënësit të mjetit të fundit pa qenë e nevojshme që të shqetësohej shumë për krijimin e inflacionit. Në aspektin negativ, ngurrimi i Bosnjës për t'u marë me depozitat e ngrira lidhet kryesisht me

<sup>27</sup> Argjentina është një rast i mirë për t'u përmendur në këtë diskutim, ku "beteja" midis depozituesve, bankave dhe qeverisë për shpërndarjen e humbjeve ende vazhonte deri në fund të majit 2002 (6 muaj pas mosplotësimit të detyrimit dhe ka penguar çdo zgjidhje).

<sup>28</sup> Në Kroaci disa ekonomistë ishin krejtësisht kundër çdo mbylljeje të bankave si diçka "e pamendueshme" dhe në vetvete shkatërrimtare për ndërmjetësimin financiar. Por këtu duhet pasur parasysh se bankat janë të veçanta, se ekziston infektimi dhe se parimet e tregut të lirë nuk duhet të zbatohen plotësisht për institucionet që pranojnë depozita.

<sup>29</sup> Për më shumë hollësi shih Šreb dhe Šonje (2001).

aftësinë e ulët fiskale për të shlyer borxhin publik. Shtyrja e shlyerjes së depozitave të siguruara për dy vjet nga ana e Kroacisë ka të njëjtën natyrë. Dhe shtyrje të tilla minojnë besueshmërinë e sistemit financiar në tërësi. Për më tepër, buxhetet e rrepta i pengojnë vendet dhe politikanët që të miratojnë zgjidhje më popullore (për të fituar vota) siç është shoqërimi i humbjeve të sistemit financiar. Në këtë mënyrë ata shmangin (ose të paktën zvogëlojnë) rrezikun moral që është i pashmangshëm nëse zbatohen dorëzanimet bujare.

5. Më së fundi nuk ka dyshim se krizat financiare kanë disa efekte pozitive. Pas krizës, çdo vend bën përpjekje më të mëdha për të stabilizuar sistemin financiar. Prandaj, ne madje mund të gëzoheshim për krizat financiare. Përveç kësaj, krizat financiare janë një tipar shumë i zakonshëm në shumë ekonomi.<sup>30</sup> Sipas Lindgren e të tjerë (1996), qysh nga viti 1980 më shumë se tre të katërtat e anëtarëve të Fondit Monetar Ndërkombëtar kanë pasur probleme të mëdha bankare. Duke u mbështetur në këtë është me vend të nxirret përfundimi se ato janë disi një karakteristikë e rregullt dhe jo një përjashtim i ekonomive të tregut. Pra, nuk duhet të çuditemi nga kriza, por përkundrazi duhet të zgjidhim krizën e tashme, të nxjerrim disa mësim dhe të përgatitemi për tjetrën. Fati është që krizat e tjera të mos vijnë tepër shpejt. Por, siç ka thënë Louis Pasteur: "Fati i favorizon të përgatiturit."

---

<sup>30</sup> Në Shqipëri për shumë kohë mbeti e paqartë cili duhet të merrej me skemat piramidale. Në Bosnjë qysh nga viti 1997 agjencitë bankare të subjekteve kanë qenë përgjegjëse për çështjet bankare dhe në Kroaci këtë përgjegjësi e ka Banka Qendrore. Shih tabelën 2.5.